

BIBLIOTEKA
SHTETIT

834-2
596.

BARDHOK SULEJMANI

DRAMË

THEMELE
TE FORTA

814-2
596.

**BARDHOK
SULEJMANI**

THEMELE TË FORTA

Dramë me dy pjesë

~~7288~~
1982

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BARDHOK
SULEJMANI

THEMELE
TË FORTA

Drame me dy pjesë

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1978

VETAT

DEDE BARDHI	Sekretar i organizatës-bazë të Partisë
SIMONI	Drejtor i ndërmarrjes
SOTIRI	Inxhinier i ri
KOLA	Brigadier, komunist.
PJETRI	Mekanik, komunist
GJONI	Punëtor
LEKA	Punëtor i ri
BARDHË GJOKA —	Babai i Dedës
MARTA	Motra e Dedës
LLAZAR KORBI	Inxhinier
PANDI	Specialist
GJIN BIBA	I ati i djalit që është fejuar me Martën.

Dy specialistë të huaj, mekanikë, metalurgë dhe punëtorë të tjerë.

Ngjarjet zhvillohen në vitet gjashtëdhjetë, kur specialistët e huaj u larguan nga vendi ynë.

PJESA E PARË

Prologu

Takimi i fundit me specialistët e huaj në prapagun e largimit të tyre. Në vendtakimin, ku do të zhvillohet biseda, kanë ardhur Deda me Simonin. Më pas vjen inxhinier Llazari me dy specialistët e huaj.

SPECIALISTI I PARË — Kështu pra, kini kërkuar takim.

DEDA — Po. Uluni, zini vend.

SPECIALISTI I PARË — Po ju dëgjojmë.

SIMONI — Ka disa kohë që punët nuk po venë mirë në fabrikën tonë.

SPECIALISTI I DYTË — Dhe për këtë e kemi fajin ne?

SIMONI — Ju lutem, unë nuk e thashë një gjë të tillë. Fakti është se punimet po ecin ngadalë, grafiku nuk po zbatohet e në këtë mënyrë përfundimi i veprës në afatin e caktuar po rrezikohet.

SPECIALISTI I PARË — Ne këtu kemi ardhur me cilësinë e këshilltarit.

DEDA — Jo vetëm të këshilltarit.

SPECIALISTI I DYTË — Ç'doni të thoni me këtë?

DEDA — Dua të them atë që është: keni ardhur si specialistë për të rikonstruktuar e zgjeruar fabrikën e shkrirjes.

SPECIALISTI I DYTË — Në qoftë se punët s'kanë vajtur mirë, apo s'kanë ecur sipas grafikut, për këtë nuk përgjigjemi ne.

DEDA — Po kush duhet të përgjigjet?

SPECIALISTI I DYTË — Ju që s'kini ditur ta organizoni punën.

SIMONI — Në qoftë se do të vazhdoni të përgjigjeni kështu...

DEDA — Më fal, shoku Simon, një minutë. Le t'i marrim punët shtruar dhe me gjakftohtësi. Ne, natyrisht, mbajmë përgjegjësi për çështjet që na takojnë e, ashtu siç e mbajmë ne, duhet të mbani edhe ju pjesën që ju përket. Ja, për këtë ju kemi thirrur.

SPECIALISTI I PARË — Të bisëdojmë, apo të na kërkoni llogari?

DEDA — Të sqarohemi për disa gjëra dhe të vemë pikat mbi i.

SPECIALISTI I PARË — A doni të dini pse s'po ecin punët e pse s'po realizohet plani?

SPECIALISTI I DYTË — Sepse urdhërat tona nuk janë zbatuar nga punëtorët dhe specialistët shqiptarë. Ja, kjo është e gjitha.

DEDA — Në kontratë kjo gjë është përcaktuar qartë. Urdhërat jepen nëpërmjet këshillit teknik e në këshillin teknik përveç jush ka dhe të tjerë.

SPECIALISTI I PARË — Derisa na pranuat, duhet edhe të na dëgjoni.

SIMONI — Me cilësinë e këshilltarit.

SPECIALISTI I DYTË — Po.

SIMONI — Gjë që do të thotë se këshillat tuaja do t'i dëgjojmë e do t'i zbatojmë, atëherë kur të na duken të drejta.

SPECIALISTI I PARË — Mos do të thotë kjo se ne kemi dhënë urdhëra të padrejta?

SIMONI — Këtë po e thoni ju.

SPECIALISTI I DYTË — Me ju është vështirë të punohet. Nga njëra anë e thoni vetë se nuk merrni vesh, nga ana tjetër urdhërat, më falni, këshillat e specialistëve nuk doni t'i dëgjoni.

DEDA — Dëgjo këtu, or mik, në shtëpinë e tij urdhërat i jep i zoti i shtëpisë e askush tjetër.

SPECIALISTI I DYTË — Kjo që po bëni ju nuk është aspak miqësore. Çështja kryesore qëndron gjatë. Ju e keni humbur besimin tek ne.

DEDA — Po pse s'i bëni pyetjen vetes tuaj se ç'na ka detyruar të humbim besimin, po që se ju e keni konstatuar këtë?

SPECIALISTI I PARË — Ne vazhdojmë të punojmë, ashtu siç kemi punuar.

SIMONI — Atëherë më lejoni t'ju kujtoj: pse nuk po zbatohet kontrata që kemi lidhur? Pse nuk kanë ardhur pjesët e ndërrimit e makineritë për ngritjen e fabrikës? Përse këto zvarritje kaq të gjata? Si ta shpjegojmë këtë qëndrim?

SPECIALISTI I DYTË — Kjo nuk është në dorën tonë. Ka të tjerë sipër nesh.

SIMONI — Ne juve ju njohim si përfaqësues të firmës.

SPECIALISTI I PARË — A të flasim hapur?

DEDA — Ne, deri tani, për palën tonë, hapur kemi folur. Ç'vërejtje kemi pasur, hapur ua kemi thënë.

- SPECIALISTI I DYTË — Kurse tani po veproni pra-
pa shpine.
- DEDA — Kjo s'është e vërtetë. Bile dhe atëherë kur
sjelljet tuaja s'na kanë pëlqyer, kemi bërë një
sy qorr e një vesh të shurdhër, duke ju konsi-
deruar si miq. Por çdo gjë ka një kufi.
- SPECIALISTI I DYTË — Kështu jeni sjellë ju edhe
me specialistët jugosllavë më, 48.
- DEDA — Ju lutem, mos bëni provokime.
- SIMONI — Ç'doni të thoni me këtë?
- SPECIALISTI I PARË — Se ju nuk pranoni t'ju më-
sojë njeri.
- DEDA — Ne kurrë nuk kemi pranuar e nuk do të
pranojmë që të tjerët të ndërhyjnë në punët
tona. Këtë kapitull mos e hapni.
- SPECIALISTI I DYTË — Meqë ra fjala.
- DEDA — Mos doni të thoni se i kemi dëbuar kot që
këtëj? Apo doni t'i merrni në mbrojtje? Këtu
s'është as vendi, as koha për të diskutuar këtë
çështje. E para e punës nuk jemi të detyruar
t'i japim llogari kujt për këtë çështje dhe as-
që e keni të drejtë të kërkoni llogari.
- SPECIALISTI I PARË — Nxeheni shpejt.
- DEDA — Kur na ngacmojnë pa të drejtë, ose kur për-
piqen të na mohojnë të drejtat tona.
- SPECIALISTI I DYTË — Kështu siç veproni ju, asqë
do t'ju vijë gjë, prandaj...
- SIMONI — Prandaj?
- SPECIALISTI I DYTË — Duhet t'i matni fjalët, para
se t'i lëshoni.
- SPECIALISTI I PARË — Më përpara është e nevoj-
shme të sqarojmë disa gjëra.
- DEDA — Këto i vini si kushte?
- SPECIALISTI I PARË — Tani për tani kështu.

- SIMONI — Kjo është përgjigja juaj e prerë?
- SPECIALISTI I DYTË — Këtë jemi të autorizuar t'juaj themi.
- LLAZI — Na duhen pjesët e këmbimit për fabrikën, në gjërat e tjera ne nuk kemi punë.
- SPECIALISTI I PARË — Për këto që po ndodhin nuk është faji juaj.
- SIMONI — Ajo dihet, është i juaji.
- SPECIALISTI I PARË — As yni.
- DEDA — *(E ka kuptuar hilen.)* Po i kujt?
- SPECIALISTI I DYTË — Personalisht ju nuk keni faj.
- DEDA — Po cili është fajtor në këtë mes?
- SPECIALISTI I PARË — Udhëheqësit tuaj.
- DEDA — *(Me ton të prerë).* Ky është provokacion! S'keni të drejtë t'i zini në gojë. Ne flasim për çështjet e fabrikës dhe të materialeve, që duhet të na vinin në bazë të kontratës; për çështje të tjera nuk ju lejojmë të bisedoni. Ju jeni provokatorë.
- SPECIALISTI I DYTË — Po na akuzoni!
- DEDA — Dikur kështu si ju vepruan edhe ata, që tani e tërë bota i njeh si renegatë dhe armiq të betuar të marksizëm-leninizmit.
- SPECIALISTI I PARË — Kjo është e padurueshme, po na krahasoni....
- DEDA — Ne do të gjykojmë për qëndrimin tuaj dhe për provokimet që na bëni.
- SPECIALISTI I DYTË — Kështu si veproni ju, fabrika e shkrirjes së mineralit nuk ka për t'u ngritur kurrë.
- SPECIALISTI I PARË — Do t'ju mbetet gërmadhë fabrika që keni nisur.

SIMONI — Ngritjen e fabrikës ne nuk e vëmë në diskutim.

SPECIALISTI I DYTË — Pse, mos ju gënjen mendja se mund ta ndërtoni edhe pa ne?

DEDA — Ne kemi ku të mbështetemi.

SPECIALISTI I PARË — Asnjeri s'do t'ju ndihmojë.

DEDA — Nuk presim ndihma as nga imperialistët, as nga revizionistët. Dhe në doni të dini ku do të mbështetemi, po jua themi: te vija e Partisë sonë dhe te energjitë e masave.

SPECIALISTI I PARË — Po na detyroni të largohemi.

DEDA — Ne s'detyrojmë askënd të largohet, por po deshët të ikni, udhë e mbarë ju qoftë!

SPECIALISTI I DYTË — Keni për t'u penduar.

DEDA — Jo. Keni gjëra të tjera?

SPECIALISTI I PARË — Në po ikim. Po qe se ndryshoni mendje, mund të vimë më vonë, t'ju ndihmojmë për ngritjen e fabrikës.

DEDA — Atëherë është mirë ta dini dhe ju që tani e të ikni me mendje të fjetur: këtu s'keni për të shkelur më! Oxhaqet e fabrikave më lart do t'i çojmë, se kemi Partinë tonë heroike që na prin në rrugën e marksizëm-leninizmit fitimtar. (*Ngrihen, Deda dhe Simoni e nisen; për pak mbetën vetëm Llazi dhe dy specialistët.*)

SPECIALISTI I PARË — (*Llazit*) Ti do të mbash lidhje me ne nëpërmjet një përfaqësie diplomatike. Do të të gjejnë vetë ata. Do të veprosh ashtu si biseduam. Udhëzimet e tjera do t'i marrësh më vonë. Më jep atë kutinë e cigareve që keni blerë te ne. (*E merr.*) Kjo kuti do të të shërbejë si mjet për lidhje.

SPECIALISTI I DYTË — Ti je i zgjuar dhe do të
dish të punosh me kujdes e pa u zbuluar. Për
gjithçka do të kesh kujdes.

SPECIALISTI I PARË — Fabrika e shkrirjes së meta-
lit nuk duhet të ngrihet.

Errësim

Tabllo e parë

Punohet për ngritjen e fabrikës së shkrirjes së mineralit. Ambient pune. Pamja kryesore paraqet vendin, ku janë hedhur themelet e fuurrës vatërxhakëtë. Aty është fronti kryesor e më me përgjegjësi. Dy punëtorë mekanikë po punojnë për montimin e bazamenteve të fuurrës së shkrirjes; të tjerë kalojnë nga një sektor në tjetrin me vegla pune e materiale.

KOLA — Shtrengoje, shtrengoje... edhe pak... edhe pak...

PJETRI — Mjaft e ka, o Kolë Përgjini!

KOLA — Edhe pak, o Pjetër!

PJETRI — Na lodhi.

KOLA — Themelet duhet të jenë të forta, prandaj t'i çimentojmë e çelnikosim sa më mirë, që të qëndrojnë gjatë.

PJETRI — Themeli qëndron vetëm kur gjakoset. Kur hidhnim themelet e kullave, pritej dashi dhe i vihej rrotull themelit, duke ia tërhequr këken dashit zvarë, që të mos mbetej pa gjak asnjë anë. Kurse këtu, o Kolë, drejtori u tregua

i kursyer, nuk na solli asnjë gjel. Apo e kam gabim?

KOLA – Gabim e ke.

PJETRI – E si e paskam gabim?

KOLA – Për këto themele është derdhur shumë gjak, 28 mijë njerëz flijuan jetën.

PJETRI – Po, për nder, ke të drejtë!

(Hyn Llazi.)

LLAZI – Ç'po bëni kështu?

KOLA – Ja, (Tregon me dorë!), po çimentojmë e montojmë themelet e furrës vaterxhaketë.

PJETRI – Atje kemi vendosur hekurat për montimin e xhaketave metalike.

LLAZI – (Kontrollon, nxehet.) Shumë keq!

PJETRI – (Çuditet.) Pse?!

KOLA – Si kështu, shoku Llazi?

LLAZI – Shumë keq! (I shikon; paузë). Shumë keq ju thashë. Kështu si e keni bërë ju, fabrika s'ka për t'u ngritur kurrë.

KOLA – (Me habi). Për ngritjen e saj po punojmë.

LLAZI – Pse, kështu punohet? (Shikon punën e bërë.) E keni bërë keq. Po kush ju tha ta montoni kështu?

PJETRI – Inxhinieri.

LLAZI – Cili inxhinier?

KOLA – Inxhinier Sotiri.

LLAZI – Pika që s'i bie edhe inxhinier Sotirit. S'ka haber fare nga kjo punë.

PJETRI – Përse?!!

LLAZI – I rroftë shkolla që ka kryer!

KOLA – Pse, gabim e kemi bërë?

LLAZI – Edhe pyetni?!.. Habitem.. bile edhe me ju habitem.

KOLA — Nuk po ju kuptojmë, inxhinier Llazi.

LLAZI — Edhe ju nuk duhet të punoni qorrazi.

PJETRI — Këtu keni të drejtë, shoku Llazi, edhe ne qorrazi po punojmë.

KOLA — Po mirë, o shoku inxhinier, kur ne punojmë qorrazi, ju pse nuk po na drejtoni mirë?

PJETRI — Edhe kështu nuk ecet. Sot ndërto, nesër prish. Është mirë të mbledhim mendjen.

LLAZI — Po kërkon llogari?!

KOLA — I kërkojmë vetes më parë, se ngritja e fabrikës sonë po bëhet si ajo historia e kalasë së Shkodrës. E dini ju atë histori?

LLAZI — (Nxeht e flet me ton urdhërues.) Të tilla historira nuk dua. Unë kërkoj rregull, punë dhe disiplinë... punë me cilësi të lartë.

PJETRI — Këto kërkojmë edhe ne. Kemi bërë disa propozime për çështjen e prodhimit të disa pjesëve të këmbimit për fabrikën, por nuk na keni dhënë përgjigje. Përse hezitohet, shoku Llazi?

LLAZI — (Me kompetencë.) Ç'propozime janë ato? Apo në vend që të vemë vetulla, të nxjerrim sytë. Jo, këtë nuk kemi si ta pranojmë dhe as duhet ta pranojë njeri.

KOLA — (Me dashamirësi.) Ne nuk e kemi shkollën tënde, shoku Llazi, por, ama, disa gjëra për furrën e shkrirjes i dimë. Na e dëgjoni fjalën.

LLAZI — (Me takt zbutës) Ti, o Kolë, je i vjetër dhe e mban mend mirë sesi na shkonin punët, edhe kur kishim specialistët e huaj këtu.

PJETRI — Po ata nuk çanin kokën, shoku Llazi, s'ju bëhej vonë, e sidomos kohët e fundit punonin fare pa përgjegjësi. Me një fjalë bënin sikur

punonin, dhe, ta themi troç. më shumë pengonin.

LLAZI — Sidoqoftë, ata ishin specialistë të zotë, kishin përvojë, që ne na duhet kohë për ta fituar.

KOLA — Në punë e sipër do të mësojmë. Këtu nga ne kemi një fjalë të urtë: «Pa hyrë në ujë, nuk mësohet noti».

LLAZI — Nuk mund të bëjmë prova me fabrikën. U nxituam pak me ata... Ne duhet t'i trajtonim ndryshe... t'i shfrytëzonim, sa të ndërtonim veprën.

PJETRI — Mirë boll ua bëmë atyre, se nuk duroheshin, o shoku Llazi, Pastaj, sikur i dëbuam ne; vetë ikën?

KOLA — Miku të rrijë si mik, o shoku Llazi. Po filloi të japë urdhëra, ai tregon se ka synime të këqija. Këtë di të them unë.

PJETRI — Të kisha unë shkollën tënde, as që pyesja për ta. I kisha përcjellë me kohë... I zoti e di se ku i pikon shtëpia.

LLAZI — Mos u nxitoni, jemi vend i vogël dhe i pazhvilluar, prandaj ua kishim nevojën.

KOLA — Mos duhet t'u shtrinim dorën, apo t'u binim në gjunjë, siç kërkonin?

LLAZI — Nuk them atë...

PJETRI — Jo, o shoku Llazi, s'do t'ia shtrijmë dorën kurkujt, se shqiptari nuk i është përkulur në ditë të vështira e jo më sot. Zotër të fabrikës e zotër të vendit jemi ne.

LLAZI — S'është puna aty, por te zhvillimi shkencor. Disa probleme që shkenca i ka zgjidhur prej kohësh, ne nuk i dijmë ku bien me shtëpi.

- KOLA — Po ne s'qënkemi të zotë të merremi me shkencë?
- LLAZI — (*Zihet ngushtë.*) Nejshe, ne duhet të marrim masa të forta, se ka rrezik që ngritja e fabrikës të vonohet disa vjet.
- KOLA — (*I habitur*) Disa vjet?! Metalina e kuqe duhet të rrjedhë që këtë vit me rastin e festave të nëntorit dhe të Kongresit. Ne kështu u zotuar.
- LLAZI — (*Do të largohet nga biseda dhe vendi; shikon punën që është bërë*). Me fjalë është lehtë. Kështu pra, kjo që keni bërë duhet prishur.
- KOLA — Si?! Të priset?!
PJETRI — Nuk e prishim pa dhënë hesap ai inxhinier Sotiri; që ia ka futur kuturu.
- LLAZI — Lereni inxhinier Sotirin, se aq di. Ju bëni kështu si them unë.
(*Vjen Dedë Bardhi, i cili ka dëgjuar fjalët e fundit*).
- DEDA — Si është puna, shoku Llazi?
- LLAZI — Telashe teknike, shoku Dedë Bardhi. Kalojmë nga zyra që të bisedojmë më shtruar. (*U hedh dorën kraheve punëtorëve*). Ju veproni ashtu siç ju thashë. (*Deda dhe Llazi, kalojnë për në zyrë, ndërsa punëtorët, mendojnë para se të fillojnë zbatimin e urdhërit*).
- KOLA — Ç'të bëjmë?... Urdhër... Hajde, o Pjetër, prish e ndreq, u bë kjo punë!
- PJETRI — (*Pauzë, mendohet.*) Kolë, kjo s'duhet prishur. Të japë hesap ai inxhinier Sotiri, të ballafaqohet me Llazin dhe me Pandin.
- KOLA — Do të pëlleshë sherri si gjithnjë.
- PJETRI — Kokën hëngshin që të tre. (*Errësohet ven-*

di ku punojnë dhe ndriçohet vendi ku bisedojnë Deda me Llazin).

LLAZI — Më duket se fabrikën nuk do të arrijmë ta ngremë.

DEDA — (Çuditet.) Uaaa, ç'është ky pesimizëm?

LLAZI — E kam shoshitur e shoshitur me mend tash sa ditë dhe e shoh të pamundur.

DEDA — (I nevrikosur) Të pamundur, po përse?

LLAZI — Gjërat dihen. Nuk i kemi bërë mirë llogaritë dhe ka shumë të ngjarë të dështojmë.

DEDA — Po ju punuat me laps në dorë dhe më së fundi arritët në përfundimin të zgjidhnit këtë variant.

LLAZI — Llogaritë nuk dalin. Prodhimi ka dhe anë të panjohura.

DEDA — Nuk rrihet gjithnjë në kapërcyell. Edhe mat e ç'mat, s'bëhet. Ngritjen e fabrikës për shkrirjen e metalit Partia na e ka ngarkuar ne. Prandaj duhet të marrim të gjitha masat tekniko-organizative, që t'ia dalim në krye.

LLAZI — Me zor nuk bëhet.

DEDA — Interessant, shoku Llazi, ju ishit shumë optimist gjer dje.

LLAZI — U krijuan vështirësi të paparashikuara, të cilat nuk mund të kapërcehen lehtë.

DEDA — Të lehtën e kemi lënë mënjanë, tani kemi marrë të rëndën. A ka vështirësi që të mos kapërcehet?

LLAZI — Kam dëshirë të më kuptoni drejt... (I zënë ngushtë)... por... akoma s'më keni kuptuar...

DEDA — Ndoshta.

LLAZI — (Me dinakëri) Unë jam specialist; pa u mburrur mund të them se një farë përvoje për

1982

LIBRI I...
17

~~1982~~

shkrirjen e metalit e kam. E kush do të donte më shumë se unë t'ia dilnin mbanë?

DEDA — (Njerëzor) Atëherë të bëjmë ç'është e mundur, që t'ia arrijmë qëllimit. Të mos e përdorim fjalën «e pamundur», se ajo na pengon e s'na le të ecim përpara.

LLAZI — Por ama duhet të dimë një gjë: për ngritjen e fabrikës kishte pikëpyetje që kur ishin specialistët e huaj këtu.

DEDA — Ai kapitull u mbyll. Tani të shikojmë ç'do të bëjmë vetë.

LLAZI — Por s'kemi forca, mor shoku sekretar! Mos harro se është proces teknologjik i ndërlikuar...

DEDA — (Ia merr fjalën.) Të përpiqemi ta mësojmë.

LLAZI — Po si, në ç'mënyrë?

DEDA — Nga librat dhe praktika.

LLAZI — Mirëpo a e ke menduar ndonjëherë se ç'bëhemi unë e ti po s'doli me sukses kjo punë? Se kjo dihet, ti e unë do të përgjigjemi të parët dhe s'është çudi të na shpien në gjyq si shpërdorues e sabotatorë.

DEDA — Mos, bre burrë!

LLAZI — Të gjitha duhen menduar.

DEDA — Dhe po dolëm me sukses?

LLAZI — Oh, atëherë kush do të jetë si ne. Do të na lavdërojnë, do të na falenderojnë. Kushedi dhe ndonjë shkrim në gazetë.

DEDA — Atëherë pse të mos mendojmë këtë, por të keqen?

LLAZI — (I zënë ngushtë para vendosmërisë së Deds.) Ju më jepni zemër, por, disa të tjerë ngatërrojnë punë.

DEDA — Cilët?

LLAZI — Disa çunakë e ca analfabetë.

DEDA — Për këto mos u shqetësoni, shoku Llazi. Unë kam besim te ti, sepse jeni inxhinier me aftësi.

LLAZI — Faleminderit për konsideratën. Ju, si sekretar i organizatës-bazë keni një përgjegjësi më të rëndë se gjithë të tjerët.

DEDA — Hajt pra, se s'po vrasim kuçedrën. Të gjithë bashkë.

LLAZI — Së bashku, së bashku, por kur të vijë fundi, ty do të të mbetet barra kryesore. Ata që flasin andej-këndej do të struken e s'do të ndihen më. po ndodhi gjë. Prandaj unë ngul këmbë që të mendojmë mirë e me gjakftohtësi, të mos nxitohemi. Një vit më shpejt a një vit më vonë, nuk ka shumë rëndësi.

DEDA — (*Mendon.*) Si s'paska rëndësi? Edhe një ditë më parë ka rëndësi.

LLAZI — (*E merr me të mirë, por me dinakëri.*) Jo, e kam fjalën që të respektojmë kushtet dhe kërkesat teknologjike.

DEDA — Domosdo, ne kuturu nuk do të ecim.

LLAZI — Si më i moshuar që jam, në se më lejoni, dua t'ju jap një këshillë.

DEDA — Ju lutem, dō t'jua di për nder.

LLAZI — (*Sikur e tërheq mënjanë, shikon anash, ul zërin.*) Mos u rrëmbeni para problemeve që ju dalin dhe hapi mirë sytë se armiku kërkon t'i fusë hundët edhe këtu në ndërmarrrjen tonë.

DEDA — Ç'thua kështu, shoku Llazi Korbi!!!

LLAZI — Mos u rrëmbe, djalë i mirë, këto janë vetëm dyshime.

DEDA — A dyshoni te ndonjë person?

LLAZI — Dyshoj.

DEDA — Po te cili, shoku Llazi?

LLAZI — Tani për tani, nuk kam fakte, por do të përpiqem t'i gjej. Puna dhe veprimtaria e tij do ta tregojnë, prandaj të shtojmë vigjilencën.

DEDA — Të gjithë e kemi për detyrë të jemi vigjilentë dhe mua më vjen mirë që edhe ti mendon kështu.

LLAZI — I tillë kam qenë gjithnjë, shoku Dedë, dhe i tillë do të jem gjithmonë.

DEDA — Bisedën për këtë çështje do ta vazhdojmë. Themelet e fabrikës duhet të jenë të pastra e të shëndosha.

Errësim. Fundi i tablosë së parë

TABLLO E DYTË

I njëjti ambient si i tablosë së parë, por me disa ndryshime të vogla. Është natë, Dedë Bardhi ka organizuar një takim me komunistët në frontin^o e punës.

DEDA — Kanë ardhur të gjithë komunistët?

PJETRI — Po, shokë Dedë.

DEDA — Afrohuni, shokë, afrohuni!

KOLA — A këtu do të mblihdemi?

DEDA — Këtu, te themelet e fabrikës. Një takim të shkurtër kemi, prandaj zini vend. *(Të gjithë kanë zënë vend dhe presin.)* Sapo mbaroi mbledhja e plenumit të Komitetit të Partisë së rrethit dhe unë po vi fill prej andej. Ju e dini, mbledhja u bë, për të shqyrtuar si kanë ecur punët.

KOLA — Ne si dolëm?

DEDA — Na kritikuan. Ama qe një analizë e fortë, që s'është parë tjetër herë. Me frymë të lartë revolucionare dhe shumë konkrete.

GJONI — Pa na thuaj një herë, pse na kritikuan?

DEDA — Për ato që di edhe ti, sepse po punohet me ritëm të ngadalshëm, sepse nuk po

realizohen grafikët e përcaktuar, ka shumë sorollatje e zvarritje; të gjitha këto rrezikojnë ngritjen e fabrikës.

GJONI — Shumë gjëra nuk varen nga ne.

SIMONI — Prit, shoku Gjon, të dëgjojmë shokun Dedë.

KOLA — Të gjejmë shkaqet dhe të përcaktojmë rrugët, shokë.

GJONI — Shkaqet dihen.

SIMONI — Edhe nuk dihen.

GJONI — Si nuk' dihen, shoku drejtor? Kur materialet që na janë planifikuar të vinë nga importi, s'kanë ardhur ende as në portin e Durrësit, çfarë të bëjmë ne?

DEDA — Ato nuk do të vijnë. *(Komunistët shikojnë njëri-tjetrin; pauzë e shkurtër.)*

NJË KOMUNIST — Po kontratat?

DEDA — Ata na kanë bërë bllokadë. Po, shokë, bllokadë.

PJETRI — Kjo është poshtërsi.

DEDA — Me bllokadën duan të na detyrojnë, ose t'u nënshtrohemi atyre, ose t'i shtrijmë dorën imperializmit për lëmoshë.

SIMONI — Të shkelim mbi parimet, të gjunjëzohemi.

PJETRI — Jo, kurrë!

TË GJITHË — *(Të revoltuar.)* Kjo s'ka për të ngjarë kurrë! Le të çirren sa të duan. Nuk na njohin mirë.

DEDA — Ata kanë tradhtuar çështjen e madhe të revolucionit, prandaj gjithçka mund të pritet.

NJË KOMUNIST — Dhe i thonë vetes komunistë e internacionalistë.

KOLA — Po halli i fabrikës si do të bëhet tani?

GJONI — Nuk e kuptoj një gjë të tillë.

DEDA — Ata për vete të tyre, i kanë bërë llogaritë mirë. Duke na bërë bllokadë, shpresojnë, ose të na nënshtrojnë, ose të na detyrojnë të shkojmë te boçgjezët, për të na thënë, pas-taj, se iu shitëm imperializmit për tre aspra.

KOLA — «Nga do të shkojnë shqiptarët», pyesin ata? Vallahi, nuk shkojmë gjëkund, or shoku Dedë.

DEDA — Mirë e tha, shoku Kolë, në do të shtrëngojmë më rradhët. Bllokadën do ta çajmë me duart tona. Veprat që kemi në plan do t'i ndërtojmë. Edhe fabrikën do ta ngremë.

SIMONI — Ne, si komunistë, do të jemi në ballë.

PJETRI — Sikur të mos kishte vajtur puna ndërto e prish, sot do të ishim më përpara.

DEDA — Për këto duhet të ndalet organizata-bazë e Partisë.

KOLA — Nuk po dimë kush e ka fajin.

PJETRI — Ai inxhinier Sotiri është duke punuar badihava. Gjithë punimet e tij po dalin pa bereqet.

KOLA — Kur e thërritëm ne dhe i thamë se inxhinier Llazi urdhëron të prishen. Ai i mati dhe tha se sipas skicave janë mirë. Në qoftë se janë skicat gabim, nuk është faji im.

PJETRI — Nuk po e marrim vesh këtë punë.

GJONI — Inxhinier Llazi di më shumë.

PJETRI — A më shumë a më pak, dreqi e di. Punët s'po na shkojnë mirë.

DEDA — (Kap situatën.) Shokë, nuk është çështja se mungon një material, apo një tjetër; çështja kryesore është kjo: tani që i lamë duart

nga importi, do ta ngremë fabrikën, apo jo?

PJETRI — Atë s'e luan topi.

GJONI — As që e diskutojmë.

KOLA — Po specialistët tonë, si thonë? I gjejmë dot këtu ato materiale që prisnim nga importi?

DEDA — Do të pyesim e do ta sqarojmë më vonë këtë çështje, por përgjegjësinë për ngritjen e fabrikës e kemi ne në radhë të parë, ne, komunistët. Fabrikën duhet ta ngremë, por ndonjëri edhe mund të pengojë.

GJONI — Cili pengon?

SIMONI — Armiku.

PJETRI — Ata specialistët më shumë po ngatërrojnë, se po ftillojnë.

DEDA — Mos folë kështu, shoku Pjetër.

PJETRI — Më ka ardhur këtu, (*tregon hundën*), shoku Dedë.

SIMONI — Përse?

PJETRI — Ja, për këto, shoku drejtor, që po lodhemi e s'po marrim vesh jemi në binarë, apo jo?

LEKA — Djegia e linjës elektrike lë për të dyshuar, shokë. Ju them ndershmërisht, se punën e bë më me cilësi të mirë dhe sipas porosive që na kishin dhënë ata.

SIMONI — Cilët?

LEKA — Pandi me Sotirin.

DEDA — Përsëri Sotiri dhe Pandi.

LEKA — Po, shoku Dedë... (*Mendon.*) Këta po punojnë, ashtu siç tha më parë Pjetri, kuturu.

PJETRI — Për mendimin tim ata vetë s'e kanë të qartë.

KOLA — Sotiri është i ri, aq ia pret dhe unë s'i vë shumë faj. E njoh edhe si familje. Të atin e

ka pasur kallajxhi; bridhte fshat më fshat, për të siguruar një copë bukë për kalamajt e për vete.

PJETRI — Ndërsa Pandi...

KOLA — Ndryshe puna e tij, por për punë s'ke ç'i thua.

DEDA — Është mirë të njohim njëri-tjetrin e të gjithë ata që kanë marrëdhënie me ndërmarrjen tonë. Tani shtrohet pyetja: do ta ndërtojmë fabrikën në afatin që kemi caktuar?

PJETRI — Atë që kemi vendosur nuk e lëvizim më!

DEDA — Atëherë t'i bëjmë mirë llogaritë.

SIMONI — Së pari, përgjegjësi mbaj unë, si komunist, që nuk kam vënë në punë si e sa duhet personelin inxhiniero-teknik. Ka të metat e dobësi në organizimin e punës dhe duhet ta shikojmë më seriozisht ku qëndron e metat; te zbatimi, apo te projektet?

DEDA — Ta vrasim më tepër mendjen dhe të përiqemi shumë për sigurimin e materialit; të vëmë në lëvizje më shumë se gjer tani mendimin krijues të punëtorëve. Shoku Simon, nga ana e punëtorëve, e mekanikëve dhe e specialistëve janë bërë shumë propozime. Ato duhen shqyrtuar me kujdes e përgjegjësi.

SIMONI — Kam ngarkuar Llazin për këtë.

PJETRI — Shoku Simon, është mirë të merresh vetë me propozimet e punëtorëve.

KOLA — (Ngrihet.) Me lejë, shokë?

DEDA — Urdhëro!

KOLA — Procesi më i vështirë është ndërtimi dhe montimi i furrës vatërshaketë. Mua më

duket se aty do të ngecim. Ato qenë planifikuar të vinin nga jashtë...

GJONI — Nuk do të vinë.

PJETRI — Prit një herë, o Gjon!

KOLA — E kisha fjalën te xhaketat metalike.

DEDA — Vazhdo, Kolë!

KOLA — Tani lind pyetja: çdo të bëjmë?

GJONI — Murit me kokë nuk i bihet.

DEDA — Të flasim me radhë, shokë!

KOLA — Duarkryq nuk rrihet. Të dorëzohemi para vështirësive nuk bën. Unë, si komunist, ka ditë që mendoj. Kam diskutuar me shokët, sidomos me Pjetrin dhe inxhinier Sotirin...

NJË KOMUNIST — Na u hiq me gjithë Sotir!

KOLA — Pritni, pritni... dhe kemi arritur në përfundim që xhaketat metalike t'i prodhojmë vetë.

GJONI — Punë që s'bëhet. (*Reagime të ndryshme.*)

KOLA — I kemi bërë llogaritë.

DISA — Si? Pa hë, të dëgjojmë? E keni kot.

KOLA — Dy të vjetrat po i riparojmë, po i saldojmë dhe po i kthejmë në gjendje pune, kurse katër të tjerat...

GJONI — Aty është halli.

KOLA — T'i bëjmë të reja.

GJONI — Të reja?! Pse ç'u bënë, kazanë për të larë rroba?

KOLA — Lllamarinën sipas përmasave të nevojshme e kemi; kam pyetur për këtë; elektodat dhe oksigjenin për saldimin e tyre i kemi. Atëherë, pse të mos i futemi punës vetë? Por vështirësia qëndron te konverti, atë nuk jemi në gjendje ta ndërtojmë vetë e unë jam i

mendimit që të kooprojmë me ndonjë uzi-
në tjetër mekanike.

DEDA — (Ndjen një gëzim të brendshëm, të cilin e shfaq.) Ja kështu mendojnë e flasin komunistët. Të lumtë, shoku Kolë!

KOLA — (Pasi merr miratimin e sekretarit dhe të pjesës më të madhe të komunistëve.) Saldatrici ime, së bashku me ato të shokëve të tjerë të brigadës, do të xixëllojnë qysh sonte. Vetëm kërkoj miratimin e organizatës-bazë të Partisë. A do të kemi sukses? Unë jam plotësisht i bindur se po.

LEKA — (Një komunist i ri dhe i shkathët, ngrihet tërë entuziazëm.) Zotimi i guximshëm që mori Kola të gjithëve duhet të na nxitë e të na shtojë besimin në forcat tona. Gjendjen e rrjetit elektrik e dini që të gjithë, por unë me brigadën time nuk do të dorëzohem. Do t'i qëndrojmë punës në krye ditë e natë dhe rrjetin elektrik do ta dorëzojmë në afatin e caktuar.

DISA — Të lumtë, Leka!

LEKA — Ashtu si Kola, edhe ne, do t'ia fillojmë punës që sonte.

DEDA — Kështu të veprojmë të gjithë.

SIMONI — Këto çështje do t'i shtrojmë edhe me punëtorët dhe specialistët.

DEDA — Rëndësi ka që ne të gjithë të kemi bindje të forta se do t'ia dalim në krye. Po që se ndonjë shok e ka me gjysmë zemre apo ka rezerva, le ta thotë më mirë që këtu. Pa besim s'ka pse t'i futet punës.

GJONI — Mua më duket se po nxitohemi.

SIMONI — E ka fjalën për afatin, apo mundësitë?

GJONI — (*Që nuk ka besim të plotë.*) Që të prodhojmë vetë xhaketat metalike dhe konvertin, më duket e vështirë, o shokë. Provat nuk na lejojnë të bëjmë dhe do të thosha që këto prova janë me zarar. Po dolën me sukses, bukuri. Po sikur të mos dalin? Edhe kjo duhet menduar. Atëherë si i bëhet?

KOLA — Sipas teje duhet të mendohemi shumë para se t'ia hyjmë kësaj pune, se mos kushedi dështojmë. Unë nuk them të mos mendohemi, po për të pritur s'kemi ç'të presim. Vetë do t'i bëjmë.

DEDA — Për punën e konvertit do të raportojmë edhe më lart e do të shikojmë se kush mund të na ndihmojë; për të tjerat që kemi mundësi t'i bëjmë vetë, do t'i përvishemi punës qysh sonte. A kemi ndonjë problem tjetër, a e do fjalën kush?

DISA — Jo.

DEDA — Atëherë mbledhjen po e mbyllim.
(*Të gjithë shpërndahen.*)

MARTA — (*Duke hyrë.*) Po këtu s'paska njeri! A thua të ketë mbaruar mbledhja? (*Nga ana tjetër e skenës vjen Gjin Biba. Me një buzëqeshje tinzare shikon Martën. Ajo sapo e vë re, tronditet.*) Ah!

GJINI — Po ti mos ki turp, moj nuse, mos ki turp. Ke ardhur të takosh vëllanë, sigurisht.

MARTA — Po.

GJINI — Vetëm ke zbritur prej fshatit?

MARTA — Kam ardhur me Davën. Kishim një mbledhje në Komitet të Rinisë.

GJINI — (*Me të butë.*) Ç'ka po të duhen ty mbledhjet, moj nuse? U thuaj: «Unë s'jam për ato

punë më e ua ler të tjerëve, se bëhet sherri sherr.

MARTA — Mus Tata më dërgoi.

GJINI — (*Me të butë.*) Ani, s'ka gajle. Po flas unë me tatën e po ia them dy fjalë. Apo vjen tani me mua?

MARTA — Ku?

GJINI — Po shkojmë në klub, sa për të ëmbëlsuar grykën me ndonjë gjë të butë.

MARTA — Jo, faleminderit!

GJINI — (*Me të qeshur.*) Shih, shih, edhe nga mua ke turp? Por unë do të jem babai yt i ardhshëm, moj? Që tani po ma prish? Eja, pra!

MARTA — Unë desha të takoj Dedën përpara.

GJINI — Mos m'i kurse lekët, oj trimëreshë, se baba për ty i ka. Ta gjen baba Dedën ty. Me atë kishe për të shkuar, besoj. (*Qesh. Marta ul kokën e nuk përgjigjet. Gjini del, Marta mbetet vetëm. Vjen Deda.*)

DEDA — Ç'farë ke? Pse je e mërztur?

MARTA — Asgjë.

DEDA — Ti diçka ke, Marta. Dukesh që në fytyrë.

MARTA — Po ti, si kështu, o vëlla? A e ke harruar rrugën e shtëpisë, apo s'do të vish më?

DEDA — U bëra me turp. Për fjalë të nderit kam pasur shumë punë.

MARTA — Po a ke njerëz, a ke nënë, a ke baba, pale për motrën që s'pyet. Po a kanë halle këta njerëz, po a janë gjallë? Ty s'të bije ndërmend për ne...

DEDA — Pasnesër do të vi patjetër. Patjetër.

MARTA — Po, tani që të kujtova unë.

DEDA — Këto fjalë m'i the prej vetes, apo prej babës?

MARTA — Ti prej kujt i deshe?

DEDA — Prej teje.

MARTA — Pse?

DEDA — Po motër ma...

MARTA — A, se fjalët e babës vrasin më rëndë.
(*Qeshin e takohen sipas zakonit.*) Dedë, unë
desha të bisedoj me ty.

DEDA — Paske dhe ti halle?

MARTA — E kam dhe unë një.

DEDA — A të madh, a të vogël?

MARTA — Të madh e të madh fort, bile.

DEDA — Mirë, shkojmë hamë bukë e ma thuaj
në menxë. (*Dalin.*)

Fundi i tabllës së dytë

T A B L L O E T R E T Ë

Në zyrën e Llazit. Llazi bisedon me një të ardhur nga një ndërmarrje tjetër.

LLAZI — Akoma s'e kam kuptuar, çfarë kërkoni?

I PANJOHURI — Dëshëm të bëjmë disa porosi këtu në ndërmarrjen tuaj.

LLAZI — Ne po na digjet mjekrra, kurse ju doni të ndizni cigaren.

I PANJOHURI — Qënkeni shtrënguar shumë, shoku Llazi.

LLAZI — Fabrika duhet ngritur patjetër e ne po punojmë ditë e natë.

I PANJOHURI — E paskeni marrë me turr.

LLAZI — Me realizimin e detyrës nuk ka llafe, nuk të fal njeri sot.

I PANJOHURI — Ta paskan mbledhur...

LLAZI — Ç'doni të thoni me këtë?

I PANJOHURI — Të paska hyrë lepuri në bark.

LLAZI — Nuk ju lejoj të flisni kështu. Për kë më merrni? Është detyrë e gjithësecilit të përpiqet të realizojë detyrat.

I PANJOHURI — Edhe unë për këtë kam ardhur.

LLAZI — Nga Ministria keni ardhur!!!

I PANJOHURI — Jo.

LLAZI — Nga rrethi?

I PANJOHURI — Jo.

LLAZI — *(Nxehet.)* Atëherë përjashta!

I PANJOHURI — Ule zërin. Si duket vinë shumë njerëz nga Ministria...

LLAZI — Përjashta, ju jeni provokator! Ja tani, *(merr receptorin e telefonit, i panjohuri e ndalon)*, do të njoftoj sigurimin e shtetit se një spiun ka hyrë në ndërmarrjen tonë.

I PANJOHURI — Mos u nxitoni.

LLAZI — Nuk ju dëgjoj. S'dua më asnjë fjalë.

I PANJOHURI — Kam frikë se do të bini në pozitë të vështirë.

LLAZI — Ju kanë adresuar gabim.

I PANJOHURI — Jo, shoku Llazi. Ju jeni Llazar Korbi; ju njoh mirë. *(Llazi çuditet)*. Urdhëro, ndize! *(Nxjerr kutinë e duhanit dhe ia lëshon)*. Njëpërmjet kësaj ju njoh.

LLAZI — *(Çuditet, e njeh kutinë e tij.)* Akoma nuk i paska humbur gjurma kësaj kutije të mallkuar?

I PANJOHURI — Të kujtoja si një burrë trim e të fortë, se më kanë folur shumë për ty dhe të mbajnë për një kuadër të aftë, por m'u prezantove ndryshe.

LLAZI — Kohët më kanë ligështuar.

I PANJOHURI — Besoj se u kuptuam; unë nuk kam gjë tjetër, por këtu ke postën e parë. *(I dorëzon një zarf të mbyllur e të dyllësuar)* Ata kërkojnë një raport të hollësishëm.

LLAZI — *(Pasi mendon, e shikon zarfin.)* Njëpërmjet jush?

I PANJOHURI — Të tjerëve do t'ju thoni se unë kam ardhur nga një ndërmarrje artizanati, për të porositur disa pjesë në oficinën tuaj.

LLAZI — Mirë.

I PANJOHURI — Të shtunave vini në qytet?

LLAZI — Jo çdo të shtunë. Kemi punë.

I PANJOHURI — Sido që të jetë puna, këtë të shtunë të pres te stacioni i trenit. U kuptuam?

LLAZI — Pse s'më lanë rehat? Ç'u kujtuan tani?

I PANJOHURI — Kuadrot si ju nuk harrohen, shoku Llazi.

LLAZI — Dreqi ta marrë, si u bë kjo punë.

I PANJOHURI — Me nerva më të ftohta, shoku Llazi. *(Ngrihet.)* Unë ika, në ndërmarrjen tuaj nuk porosita gjë; kështu ta kemi fjalën, e kështu t'i thoni edhe drejtorit e të tjerëve, po ju pyetën. Mirë u takofshim! *(Del. Llazi bie në mendime, nxjerr zarfin, e shikon dhe me kujdes e fut në gji, shikon andej këndeje, nuk e zë vendi, hap një dosje e mbyll një tjetër. Është i shqetësuar. Bie dera, tronditet, kërkon të marrë veten. Dera bie përsëri.)*

LLAZI — *(Pasi është ulur dhe ka hapur një projekt, sa për të thënë, merr një lapës dhe bën sikur shënon diçka.)* Hyrë! *(Ngadalë e me kujdes të madh hyn Gjini Biba.)*

GJINI — A ka mundësi të hyj, shoku Llazi?

LLAZI — *(Qetësohet dhe e merr veten.)* Po hyrë, o Gjini Biba, hyrë!

GJINI — *(Ka në dorë një trajsë të mbushur.)* Eh, o shoku Llazi.

LLAZI — Çfarë kërkon?

GJINI — Më bien në qafë, shoku inxhinier.

LLAZI — Kush?

GJINI — Të gjithë.

LLAZI — Të gjithë?!

GJINI — Po, shoku Llazi. Në punët më të rënda më dërgojnë; Gjini këtu e Gjini atje. Ma morën shpirtin.

LLAZI — Po përse të sulen më shumë ty?

GJINI — As unë nuk e di.

LLAZI — Cili të turret më fort?

GJINI — More po edhe miqtë e mi, Deda i pari, pa lëri të tjerët.

LLAZI — Pse, çfarë e ke Dedën ti?

GJINI — Po edhe larg s'jemi. Kemi një si punë krushqije. Motrën e tij e kam fejuar për djalin.

LLAZI — Po ti e paske shumë të afërt! Ç'do ti kur e paske mik sekretarin e Partisë?

GJINI — Mik... e ku ka mik tashti, o shoku inxhinier? Miq kishte në ato kohët e para. Ti, o shoku Llazi, je më i drejti e më i zoti këtu.

LLAZI — Ka të tjerë që janë më të zotë se sa unë.

GJINI — E kush është më i zoti se ti? Të gjithë të lavdërojnë, të gjithë thonë se inxhinier Llazi është i zoti i punës.

LLAZI — Po Dedë Bardhi, ç' thotë për mua?

GJINI — E e e... s'ka se ç'farë të thotë për ty.

LLAZI — Gjini Biba, ti ia përton punës... Kështu kam dëgjuar.

GJINI — Mos e beso atë fjalë. (*Nxjerr nga trajsa dy shishe raki dhe një copë mish të mbështjellë me gazetë.*) Unë përpiqem me gjithë zemër.

LLAZI — Çjanë këto?

GJINI — Asgjë, shoku Llazar, e kam bërë një pikë

raki këtë vit. Ti je jabanxhi, ta solla, jo për ndonjë gjë. Këtu ke edhe pak mish derri, për meze. Të bëfshin mirë! (*Ngrihet.*)

LLAZI — Të faleminderit, por këto shpenzime janë të tepërta.

GJINI — Asgjë, shoku Llazi.

LLAZI — S'ma shpure gjer në fund atë bisedën që nise.

GJINI — (*Gjithnjë me servilizëm.*) Po pate mundësi më dërgo në ndonjë vend pune, ku të marr ndonjë zanat, se ti e di si më ka vajtur filli mua e kam mbetur pa ndonjë profesion. Tani, o mik, nuk mundem ta përballoj punën e krahut, si përpara.

LLAZI — Ëhë!

GJINI — Pa prishur punë e pa u bërë me fjalë. Qejfin e kam të më vish ndonjë natë nga shtëpia, atje...

LLAZI — Kushedi na bëhet mbarë dhe dalim ndonjëherë të shtrohemi në sofër me malësorët.

GJINI — Mirë ardhsh!! (*I jep dorën me servilizëm dhe del.*)

LLAZI — (*Llazi merr rakinë e fut në raft dhe e kyç. Mbyll derën, ul perden dhe hap zarfin, që i pruri i panjohuri. E lexon shpejt, lëviz nëpër dhomë, siguron letrën, merr receptorin e telefonit, i bie ziles dhe kërkon.*) Alo, alo, Pandi!... Pandi... merr me vete projektin e furrës vatërxhaketë dhe të konvertit dhe ec tek unë... ja, këtu në zyrë. Mos u vono!... (*Ul receptorin e telefonit, rregullon zyrën, hap projekte e dosje të tjera, bën sikur punon, lëviz nëpër zyrë. Pas pak vjen Pandi.*)

PANDI — Shoku Llazi...

LLAZI — Urdhëro, ulu! (*I bën me shenjë.*) Ulu, do të bisedojmë. Si po shkojnë punët nëpër sektorët e ndërtimit?

PANDI — Jo mirë, shoku Llazi.

LLAZI — Për ty ka shumë vërejtje dhe kritika.

PANDI — Ç'farë të bëj unë. Ti e kupton sa vështirë e kemi. Të tjerët dinë vetëm të bërtasin.

LLAZI — Fabrika e shkrirjes së mineralit duhet ngritur.

PANDI — Për atë po përpiqemi.

LLAZI — Ti, si specialist i vjetër, si mendon?

PANDI — Ka shumë vështirësi.

LLAZI — Po nuk u ngrit, do të na venë përpara përgjegjësisë.

PANDI — E di.

LLAZI — Meqë e di, përse nuk punon më shumë?

PANDI — Ç'thua kështu, shoku Llazi? A jam kursyer ndonjëherë?

LLAZI — Me sa kuptoj unë, punën nuk e ke mirë.

Disa herë e kam ngritur problemin tënd...

PANDI — E di unë se ku e kanë hallin.

LLAZI — Ku?

PANDI — Origjina. Kemi qenë familje e pasur dhe im atë u dënua disa vjet, prandaj më marrin nëpër këmbë.

LLAZI — Lufta e klasave do të thellohet vazhdimisht, prandaj mendohu.

PANDI — S'kam ç'të bëj.

LLAZI — Unë vazhdimisht jam përpjekur të të mbrojt dhe do të të mbrojt sa të mundem, por ti edhe me mua sillesh ftohtë. Edhe mua më rri larg.

PANDI — (*Tregon hundën.*) Këtu më ka ardhur!

LLAZI — Ti nuk je trim.

PANDI — Nuk po të kuptoj, shoku Llazi.

LLAZI — A beson se fabrika do të ngrihet?

PANDI — Ata thonë...

LLAZI — Kurse unë po të them hapur, nuk besoj.

PANDI — Unë kërkoj të transferohem nga kjo ndër-
marrje.

LLAZI — Ti nuk do të largohesh, por do të qëndrosh
këtu. Do të të ngarkojmë një detyrë të rën-
dësishme.

PANDI — Të lutem, shoku Llazi, mos më ngarko
më tepër! Nuk kam mundësi të kryej këtë që
kam e jo të marr edhe të tjera.

LLAZI — Akoma nuk e ke kuptuar atë që duhet të
kuptosh?

PANDI — Jo.

LLAZI — Sonte do të bisedojmë në dhomën time.
Tani shko në punë dhe mos u shqetëso.

PANDI — Si urdhëron!

LLAZI — Mishin do ta pjekim dhe hellin nuk do
ta djegim!

Fundi i tablosë së tretë

PJESA E DYTË

TABLO E KATËRT

*I njëjti ambient si në tablotë e para. Puni-
met kanë ecur. Një grup punëtorësh punojnë
së bashku me inxhinier Sotirin te furra va-
tërzhaketë. Pas pak vjen Llazi. Duket që
është nervoz.*

LLAZI — (Sotirit). Po ti ç'bën këtu?

SOTIRI — Po punoj, si më sheh.

LLAZI — Pse, punë i thua kësaj? Je edhe inxhi-
nier dhe s'ke haber fare, fare!

SOTIRI — Ju lutem, shoku Llazi.

LLAZI — Me veprimet që po bën, je për t'u hedhur
në gjyq. Po, po, në gjyq. More vesh? Të ja-
pësh llogari deri në një për lekun e popullit.
A e dini, more shokë, se sa lekë i ka ku-
shtuar shtetit ajo pakujdesia prej kalamani e
këtij njeriu? (Sotiri do të flasë.)

SOTIRI — Po unë, shoku Llazi, jam përpjekur...

LLAZI — (Ia merr fjalën.) Leri këto, mos e zgjat më.
Ku ë more gjithë atë guxim të madh që të
bësh punë pa më pyetur mua?

SOTIRI — Shoku Llazi, nuk po merremi vesh fare në këto punë; ose më sakt, unë nuk jam në gjendje t'ju kuptoj.

LLAZI — Duhet të punosh e të mësosh më shumë. Metalurgjia është një shkencë e vështirë.

SOTIRI — Shumë punime, që kemi bërë, janë prishur kot, për mendimin tim.

LLAZI — *(Me nënvleftësim)* Për mendimin tënd.

SOTIRI — Po, shoku Llazi, se dhe herën e dytë po ashtu i kemi ndërtuar.

LLAZI — Duhet punë me cilësi të lartë se nuk po ndërtojmë furrë gëlqereje, po një furrë që do të shkrijë metal.

SOTIRI — E di këtë.

LLAZI — Çfarë di ti? Asgjë! *(E tërheq mënjanë.)* Kujdes, djalosh, nuk duhet të fluturosh. Inxhinieri nuk rrëmbehet nga pasionet dhe dëshirat, por mendon, studjon dhe këshillohet me ata që dinë më shumë e janë më të vjetër në profesion. Ata që flasin andej-këndeje, që marrin iniciativa të tepëruara, nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për gjithçka që mund të ndodhë këtu. Kush e mban përgjegjësinë, sipas mendimit tënd, djalosh, për problemet më shqetësuese?

SOTIRI — Organizata-bazë e Partisë, shoku Llazi.

LLAZI — Partia, Partia, por përgjegjësia ligjore do të bjerë mbi mua, mbi ty, mbi Pandin e specialistët e tjerë, mbi ne që drejtojmë nga ana teknike.

SOTIRI — Pse, mos jemi në rrugë të gabuar?

LLAZI — Je i ri dhe ke perspektivë të ecësh përpara e të bëhesh një kuadër i mirë për metalurgjinë, por, ama, pasi të kalosh një farë

stazhi pranë ndonjë më të vjetri e me mend në kokë.

SOTIRI — (*E merr veten.*) Një gjë duhet bërë, shoku Llazi.

LLAZI — Çfarë të bëjmë?

SOTIRI — Ose të ndërpresim punimet, ose t'i futemi punës më me ngulm.

LLAZI — Gabim mendon! Si e para dhe e dyta, gabim.

SOTIRI — (*I habitur*) Gabim!!!

LLAZI — Po. Të pezullojmë punimet nuk shkon, se një farë pune e kemi bërë dhe disa baza i kemi hedhur. Nga ana tjetër nuk do të qe mirë as nga ana politike, se do të duket sikur kemi ngritur duart, përveç problemit që ngelen 300-400 punëtorë papunë.

SOTIRI — Edhe kështu ekonomia po dëmtohet.

LLAZI — Nuk duhet të nxitohemi. Një fjalë e urtë thotë: «*Kush nxitohet, përvëlohet*»; kjo është edhe porosia e drejtorisë, se me problemet teknike nuk bëhet shaka. (*I fut krahun me dinakëri*). Tani ec të kalojmë nga sektori tjetër, se mbete këtu te furra e s'po merr vesh ç'po bëhet gjetkë.

SOTIRI — Ju faleminderit, shoku Llazi. (*Aty pari kalon Gjini Biba.*)

LLAZI — (*Me ton të prerë.*) Nga lëviz kështu, Gjini Biba?

GJINI — Po kërkoj shokun Dedë.

LLAZI — (*Rreptë*) Dedën ta kërkos, kur të bëhet pushimi, ose në mbrëmje e jo tani.

GJINI — Më falni, shoku inxhinier, por nuk pret. puna.

LLAZI — Ma thua mua!

GJINI — Është çështje familjare.

LLAZI — (*Me indiferentizëm*) Çështje familjare?! Shko, shko, prite nga zyra. (*Gjini i kalon afër Sotirit*). Si shumë sillet vërdallë ky Gjini Biba. A të ka rënë dhe ty në sy?

SOTIRI — Nuk më pëlqen. Dembeli, dembel mbetet, kudo, që ta shpiesh.

LLAZI — (*Gjoja me neveri*) Më është neveritur. Si e duron shoku Dedë Bardhi një mik të tillë?

SOTIRI — E ka zënë halli. Këtej nga këto anë zakonet janë të forta e nuk thyhen lehtë.

LLAZI — Kaqë herë jam matur të propozoj ta heqim nga puna, po ç'ti bëj e ka mik shoku Dedë (*Dalin*).
(*Ndriçohet zyra e Dedë Bardhit. Deda është duke shkruar. Gjini Biba troket*).

GJINI — A kam lejë të hyj, shoku sekretar?

DEDA — (*Pa e përfillur*) Çfarë do?

GJINI — Një hall më ka sjellë gjer këtu, në zyrën e Partisë.

DEDA — Jam i zënë. A nuk e sheh se kam punë?

GJINI — (*Servil*) Punë, punë, por duhet t'i gjesh pesë minuta kohë e t'i ndërrosh dy fjalë me mikun.

DEDA — (*E shikon rreptë*.) Me cilin mik?

GJINI — Mos bëj sikur nuk më njeh e nuk di gjë.

DEDA — Ku e ke hallin?

GJINI — (*Duke treguar kujdes*.) E di, e di, keni punë e detyrë të rëndë, por, si i thonë fjalës, jo çdo herë me gjoks, se nuk dilet në va atje ku s'ka va.

DEDA — Vaun e kërkon tjetërkush. Përse ke ardhur?

GJINI — Jo... nuk kam ndonjë hall të madh...
Po si nuk na kë dalë ndonjëherë nga shtëpia,
mor shoku Dedë?

DEDA — (*Për ta provokuar.*) Disa herë jam matur,
po më kanë thënë se të vijnë miq më të
shtrenjtë se sa unë.

GJINI — Nuk është e vërtetë, Dedë Bardhi; të
kanë gënjyer. E ku kam unë mik më të afërt
e më të dashur se sa ty e shtëpinë tën-
de?

DEDA — Kjo nuk dihet.

GJINI — Po më qëllon rëndë, burrë i dheut.

DEDA — Nuk po të qëlloj unë, por sjellja jote.

GJINI — Një miku të vjetër shtëpie, nuk i thuhet
këto fjalë.

DEDA — (*I vendosur.*) Unë miqësi me ty?

GJINI — Pse e mohon?

DEDA — Ime motër nuk është pyetur, kur është
fejuar e punët kanë ndryshuar, o Gjini Biba.

GJINI — Si, si?!

DEDA — Mendimi im është se pa dëshirën e saj kjo
punë s'ka si bëhet.

GJINI — Ti po flet përçart!

DEDA — (*I qetë*) Flas shumë qartë.

GJINI — Sot po të fal, se të ka lodhur puna e
tepërt.

DEDA — Hiç mos më fal. Ç'ke ndërmend të thuash,
thuaje! Ç'ke ndërmend të bësh, bëje!

GJINI — (*I revoltuar*) Kështu, hëë?

DEDA — Ti jo vetëm që nuk e ke të kaluarën
të pastër, por edhe sot po bën dredha. Nuk
mban më pilafi ujë, Gjini Biba.

GJINI — Ose unë s'po dëgjoj mirë, ose ti nuk je
në rregull.

DEDA — (I revoltuar) Ti, ti nuk je në rregull dhe dëgjo këtu: mos i hyrë në hile kësaj Partie e këtij pushteti se do të hash kokën tënde.

GJINI — Këto fjalë nuk i pres prej teje.

DEDA — Edhe më të rënda do t'i dëgjosh, në qoftë se...

GJINI — Duhet të ulemi një herë, ose në shtëpinë time, ose në shtëpinë tënde, ta marrim më shtruar kuvendin. Dije se je duke më rënduar tepër.

DEDA — Nuk më bëhet të rri e të ulem në një oxhak me ty.

GJINI — Deri këtu ka shkuar puna!!!

DEDA — Po.

GJINI — Mendohu pak më thellë!

DEDA — Nuk dua këshilla prej teje.

GJINI — E ke marrë tepër të nxituar revanin, o Dedë.

DEDA — Këto janë mendimet e mia. Përfundimisht fjalën do të ta dërgojë ime motër atje në oxhakun tënd.

GJINI — Sa për këtë, unë nuk kam fjalë as me ty dhe as me motrën tënde. Fjalët i kam filluar e do t'i mbaroj me Bardh Gjokën, me zotin e shtëpisë, me atë që ju ka rritur.

DEDA — Ikën ato kohë dhe s'kthehen më.

GJINI — Zakonet e këtyre maleve nuk prishen lehtë dhe fët e fët, or Dedë Bardhi.

DEDA — Ke ndonjë gjë tjetër për të thënë?

GJINI — Po.

DEDA — Hajde shpejt se kam të tjera punë më të rëndësishme.

GJINI — Ty s'të takon fare të përzihesh në këtë punë. Dhe ti do të bëje mirë të rrije mënjanë.

DEDA — Atë e di unë.

GJINI — Kështu, ë?... E po mirëupafshim!..

DEDA — Thyej qafën e për të tilla gjëra mos m'u duk më në zyrë! As në shtëpi nuk dua të ta shoh bojën!

GJINI — Atje s'ma ndalon kush udhën, se Bardh Gjoka më ka borxhe, për të larë.

DEDA — Unë them që të mos shkosh, se do të hash ndonjë kopaçe që të të vijë mendja vërdallë!

GJINI — *(Duke dalë)* Do të më njohësh.

DEDA — Të njoh, s'ka nevojë për më tepër. Futju punës, e leri vickelat, se do të gjesh belanë.

(Gjini ikën i nevrikosur në kulm. Deda vazhdon punën. Ndriçohet vendi ku punohet për ngritjen e furrës vatërshaketë. Shohim një grup punëtorësh e në mes tyre Llazin).

KOLA — Themelet i kemi hedhur të forta.

PJETRI — Edhe xhaketat metalike për furrën më duket se kanë dalë të një cilësie të lartë, shoku Llazi.

LLAZI — Të shohim, kur t'i vemë në punë. — Si thoni ju, o shokë?

DISA — Ashtu është.

LLAZI — Furrës vatërshaketë ia kam frikën. Ne po e ngrejme, por kjo ka naze shumë. Kur të ndizet, kërkon mishelë, përzierje të studjuar, sasi të koncentruar minerali, silici, qymyri, ajri, ujë e të tjera e të tjera, se nuk durom as më shumë e as më pak.

KOLA — Do të bëjmë si të bëjmë, shoku Llazi. Ca me shkollë, ca me praktikë.

LLAZI — Drejtpërdrejt me furrën merret Pandi me Sotirin.

PJETRI — Së pari jemi ne, o shoku Llazi. Apo e kam keq? (*Puna vazhdon për ngritjen dhe montimin e dy xhaketave metalikë. Vjen Dedë Bardhi.*)

DEDA — Puna e mbarë, shokë!

KOLA — Të mbarë paç e mirë se erdhe!

DEDA — U lodhët?

PJETRI — Jo, o shoku Dedë, se nuk e kemi pasur mendjen te lodhja, por te këto drej xhaketa. Besa me merak të madh kemi punuar.

DEDA — (*Pasi i shikon me kujdes.*) Ju lumtë, ju lumtë, keni bërë punë të mirë me sa shikoj. Edhe nga rrethi na kanë falendëruar për punën që kemi bërë. (*Vijnë duke u zënë Pandi me Lekën.*)

LEKA — (*I inatosur*) Shoku Dedë dhe shoku Llazi, mirë që u gjeta të dyve. Kështu nuk vazhdohet më...

LLAZI — Çfarë ka ndodhur, djema?

LEKA — Unë dua të marr vesh se kush i jep këto urdhëra?

DEDA — Për çfarë urdhërash e ke fjalën?

LEKA — Ne po punojmë pas porosive që na kini dhënë ju, shoku Llazi e sipas projektit, kurse ky, (*tregon Pandin*), vjen e fut hundët si pa gjë të keq e pa pikën e përgjegjesisë thotë: «të prishet». Dhe ç'është më e keqja na ofendon. Ku e ka marrë ky këtë të drejtë? (*I kërcënohet.*)

PANDI — Në vend që të ankojem unë për këtë, vjen e ankohet ky. Unë nuk e shoh të drejtë këtë çështje.

LEKA — Si të mos ankohe, mor shoku Dedë? Ne kemi punuar tërë natën, kurse ky vjen si kofini pas të vjelave..

PANDI — Ju lutem mos na ofendoni.

LLAZI — *(Me autoritet)* Mjaft! Edhe këtu, para nesh doni të bëni fjalë?

LEKA — Po ky...

LLAZI — Të gjitha i kuptuam. Shkoni tani tek objekti. Do të vinë atje, e do ta shohim në vend çështjen. Ndoshta kam gabuar unë dhe ai ka të drejtë.

PANDI — *(Do të shpjegohet.)* Shoku Llazi...

LLAZI — *(E ndërpret me ton urdhërues.)* Leri ato! Do ta shohim më vonë. *(Sotirit)* Shko ti, Sotir, atje, bëj një kontroll dhe eja të na raportosh një për një.

LEKA — Ç'Sotir, o shoku Llazi. Të dy njësoj janë. Çështja zgjidhet vetëm kur të vini ju me shokun Dedë, përndryshe nuk lejoj njeri të vërë dorë në punën tonë. Ku është parë kjo? Këtu ka qenë edhe Pandi edhe Sotiri. Të ishin kujtuar me kohë për të kontrolluar e për të ndihmuar si specialistë që janë. Po këta vinë, pasi piqet kulaçi.

DEDA — Më ngadalë, Lekë.

LEKA — Eh, o shoku Dedë, dhe flisni për cilësinë... Po unë kam punuar vetë me merak e pa luajtur një centimetër nga plani.

LLAZI — Mos u zini, djema! Me gjakftohtësi! Edhe inxhinier Pandi edhe inxhinier Sotiri për të mirën e punës e kanë.

LEKA — Ç'të mirë... pse kështu është e mira?

DEDA — *(Ndërhyn.)* U pa puna, shoku Llazi. Duhet të shkoni vetë, se s'bindet Leka.

LEKA — Hajdeni dhe ju, shoku Dedë.

LLAZI — *(Pandit dhe Sotirit)* Edhe ju tregoni më tepër kujdes, se po dëgjojmë mjaft vërejtje. Pse nuk shkoni në kohë e t'i qëndroni punës në krye?

SOTIRI — More, shoku Llazi...

LLAZI — T'i lemë debatet, S'është vendi këtu. Atje në zyrë.

SOTIRI — Mirë, mirë. Edhe atje do të vijmë. *(Sotiri dhe Pandi nisen).*

LEKA — Ju lutem, mos u vononi, se puna është ndërprerë. *(Ikën).*

LLAZI — Njeri energjik ky djalosh. Gjak në vetull të merr; preokupohet seriozisht për ngritjen e fabrikës. Minutën nuk ta fal.

DEDA — Të tillë njerëz na duhen, o Llazi.

LLAZI — Të tillë.

KOLA — Leka me brigadën e tij po e mban fjalën; bile po e realizon detyrën para afatit.

LLAZI — Ashtu është e vërteta; brigada elektrike ka pasur rezultate të mira pas avarisë që i ndodhi disa muaj më parë.

PJETRI — S'e gjetëm e s'e gjetëm si u shkaktua ajo avari. Ishte e rëndë, shoku Llazi?

LLAZI — E rëndë. Na shkaktoi vonesë dhe dëme materiale.

DEDA — Më tepër duhet ta rritim kujdesin.

NJË PUNËTOR — *(Që është më lart se të tjerët sheh Bardh Gjokën, që po vjen me të bijën.)*

A... kush po na vjen.

KOLA — Cili?

PUNËTORI — Bardh Gjoka me të bijën. *(Hyn Bardhi dhe Marta).*

BARDHI — Dita e bardhë!

- DISA — Të bardha paç, burri i malësisë!
- LLAZI — (*Duke i dhënë dorën*) Mirë se vjen, o babë i Dedës! (*Përshëndeten.*) Bëre mirë që erdhe të na vizitosh këtu në fabrikë.
- DEDA — Mirëseerdhe, babë! (*Përshëndeten.*)
- BARDHI — Na harrove fare, bir.
- DEDA — Për të harruar, jo, babë, por, që s'kam ardhur, kjo është e drejtë.
- BARDHI — Ti i premtove Martës se do të vije e ne prit... Hë, moj, a të tha?
- MARTA — Po baba. Na mori malli, o vëlla! (*Takohet me Dedën.*)
- BARDHI — (*Llazit*) Kam mbetur vetëm me këtë cucë.
- LLAZI — Bash si djalë duket e sa për Dedën, ke të drejtë që e kritikove, sepse duhet të kishte ardhur. Por për të harruar nuk të ka harruar. Në gojë të mban çdo ditë. Natë e ditë në punë, ama.
- BARDHI — Të punojë, o shoku Llazi, të punojë. Është i ri, e për këto ditë askush s'duhet të kursejë veten. (*Nxjerr kutinë e duhanit.*) Ndize, o Llazi një cigare prej këtij duhani, po deshe duhan të fortë.
- LLAZI — Jo, jo e duroj. Jam mësuar me duhanin e këtyre anëve.
- BARDHI — (*Shikon anash nga puna.*) Si po ju shkojnë punët?
- LLAZI — Disi... Kemi mbetur vetëm.
- BARDHI — Më mirë vetëm se me gjarpërin në gj.
- LLAZI — Fjalë me vend.
- BARDHI — Më hante merakun të vija vetë e t'ju shikoja...

LLAZI — Nuk do të dorëzohemi, Bardh Gjoka.

BARDHI — Ju lumtë, Paskeni bërë alamet pune. Andej nga fshati, sikur qenë përhapur do fjalë, sikur fabrika do të mbetet gjërma-dhë, pasi specialistët dhe punëtorët tanë nuk na qenkan të zotë. T'ju them të drejtën, më erdhi keq.

DEDA — Vështirë e kemi, por ama mineralin do ta shkrijmë, o babë.

BARDHI — Të mos e turpërojmë veten, këtë do baba.

DEDA — Shoku Llazi, a ikim tani nga punimet e tjera? Baba me motrën le të kalojnë në dhomën time, që të pushojnë pak. Urdhëro, baba, çelësin! (*Nxjerr çelësin nga xhepi.*)

LLAZI — (*Ndalon.*) Në asnjë mënyrë! Ti mos i ler vetëm. Çmally me ta dhe në darkë hajdeni nga unë me gjithë babën.

BARDHI — Për sonte, t'u rritë ndera, o mik, por nuk do të qëndroj këtu. Do të kthehem në fshat.

LLAZI — Uaa, përse kaqë shpejt?

BARDHI — Pres miq, sonte në shtëpi. E kam lënë me fjalë.

LLAZI — Qejfin e pata ta kalonim një natë së bashku. Më ka qëlluar një pikë raki e mirë e thashë të kthenim nga një gotë.

BARDHI — Ti je jabanxhi. Na takon neve së pari, o mik, prandaj mos na korit.

DEDA — Sa të lirohemi pak, se vërtet kemi pasur telashe.

BARDHI — Të pres ndonjë natë të vish bashkë me Dedën.

LLAZI — Qejfin e kam.

- BARDHI — Qejfin e mirë paç, e mirë ardhshi!
- LLAZI — *(U jep dorën.)* Shëndet e të mira! *(Ikën.)*
- DEDA — Vërtet do të ikësh që sonte? Kaq shpejt?
- BARDHI — Për kaq të doja edhe unë në shtëpi.
- DEDA — Çfarë ka ngjarë?
- BARDHI — Asgjë e keqe, por ti je djali i shtëpisë dhe duhet të marrësh pjesë si në hallet dhe në gëzimet.
- DEDA — Mirë, po kalojmë nga zyra. *(Nisen. Punëtorët në sfond punojnë për ngritjen e xhaketave metalike.)*
- BARDHI — *(Ecën duke shikuar andej-këndej.)* Mirë, mirë, po a i dini ju ato punët e holla që kërkon fabrika?
- DEDA — I dimë, baba. Tani mirë fare jo, por i dimë.
- BARDHI — Ku të mos dini, pyetni, se me të pyetur, njeriu s'humbet kurrë. Ja, dhe unë për një pyetje kam ardhur.
- MARTA — Nënë e ka marrë malli shumë. Baba e ngacmon, por ajo s'lë njeri të të shajë.
- DEDA — Shpirti më është djegur, por punët e shumta nuk na kanë lënë. Kemi pasur tela-she, moj Martë. Andej nga ju ç'po bëhet?
- BARDHI — Besa mirë po na shkojnë punët. Kodrën e thatë, ku plaste pula prej etjes, e kemi bërë tokë buke. Të ka lezet shpirti ta shohësh, sa shumëkujt i dukej, si ëndërr në diell.
- DEDA — Po të sigurojmë edhe bukën, s'ia kemi nevojën kurkujt.
- BARDHI — *(Janë futur në zyrë, e cila është vendosur në paraskenë.)* Themelet ia bëtë të shëndosha e të forta.

DEDA — Ashtu na i merr mendja.

BARDHI — (Martës) Ti, moj cucë, na ler pak vetëm me Dedën, se i kam dy fjalë me të. (Marta bën të 'ngrihet.)

DEDA — Le të rrijë Marta, nuk ka gjë.

BARDHI — Nuk janë fjalë për të.

DEDA — A ke diçka kundra Martës, a si?

BARDHI — Jo, o burrë, si të shkon mendja një herë.

DEDA — Marta është e rritur tashti dhe kupton.

BARDHI — U rrit dhe koha i ka ardhur të shkojë në derë të huaj. Miku për natë po na vjen. Kërkon të ndajmë ditën. Thashë këtë punë nuk e vendos pa pyetur Dedën, se Marta një vëlla ka e po të mos ndodhet ai në dasmë, nuk ka gëzim në shtëpi.

DEDA — Kush të vjen në shtëpi?

BARDHI — Dhe pyet? Gjin Biba!

DEDA — Gjin Bibën nuk e kemi mik.

BARDHI — A e di unë kë ka mik shtëpia, a e di ti?

DEDA — Edhe në e ke mik, atë miqësi duhet ta prishim.

BARDHI — Ti me miqtë e tu prishu e ndreq, kur të duash. Për miqtë që kam zgjedhur vetë, përgjigjem unë.

DEDA — Pse u ngatërrove me atë miqësi, pse na i fute atë njeri në shtëpi?

BARDHI — Në se je grindur ti me Gjin Bibën e nuk do ta shikosh me sy, mos ia bëj shtëpisë këtë turp.

MARTA — (Me kokën ulur) Po unë...

BARDHI — Pusho, ti, akoma nuk të ka ardhur radhë për të folur.

- DEDA — Le ta thotë fjalën e vet edhe Marta.
- BARDHI — *(I zënë para së papriturës.)* Mos doni të më turpëroni tani në pleqëri? Bardh Gjoka nuk e ka zakon t'i hajë fjalët.
- DEDA — Nuk ka ndonjë turp në këtë mes.
- BARDHI — Për ty po, se ty aq të bën, por zakonin e kanunin unë nuk e thyej.
- DEDA — Po ti prit, babë!
- BARDHI — Nuk kam se çfarë të pres. Nuk bëhem i pari bidat në këto anë. Jo, jo, nuk e koris fisin e shtëpinë e Gjokajve.
- DEDA — *(Shtruar)* Miqësinë me Gjijn Bibën duhet ta prishim për dy arsye.
- BARDHI — Çfarë? Unë erdha të ndaj ditën e martesës, ti më thua havaze të tjera.
- DEDA — E para, Gjijn Biba nuk është burrë i mirë. Këlysh i gjithkujt ka qenë, në çdo sahan ka lëpirë, xhandar i Zogut, me të huajt është bërë, me Ballin e me milicinë fashiste, vetëm më pushtetin tonë nuk i ka ecur.
- BARDHI — Ashtu ishte koha.
- DEDA — Kurse e dyta, fejesa e Martës me djalin e tij, është bërë sipas zakoneve të vjetra. Marta as e ka parë dhe as e njeh djalin e tij.
- BARDHI — Ti me këto fjalë je?
- DEDA — Po.
- BARDHI — Atëherë rri me shëndet. Unë me cucën po shkojmë nga erdhëm.
- DEDA — Jo, të merremi vesh!
- BARDHI — Këto nuk janë për mua.
- DEDA — Nuk më ke dëgjuar, baba!
- BARDHI — Djalë të kam, të dua shumë, por në këto punë mos m'u përzi!
- DEDA — S'kam se si të hesht.

BARDHI — Këtë punë e kam nisur unë dhe unë do ta përfundoj.

DEDA — E keni nisur vetëm, por do ta përfundojmë së bashku.

BARDHI — Jo.

DEDA — (*Me gjerësi e përzemërsi.*) Më thuaj një fjalë, babë. Kur nis një shteg e del në hon, a duhet të hidhesh në hon, a të kthehesh prapa.

BARDHI — Domethënë unë jam nisur gabim.

DEDA — Gabim. Unë atëherë nuk dija asgjë, për të kaluarën e tij e këto që po të them vonë i kam mësuar.

BARDHI — Në malësi nuk i ndalet cuca mikut.

DEDA — Tani edhe do t'i ndalohej.

BARDHI — Kërcet pushka.

DEDA — Kanë vdekur ata burra që shtinin pushkë për të tilla ngatërresa.

BARDHI — Kjo punë nuk mund të bëhet.

DEDA — As unë e as ti nuk duhet të ulemi në një sofër me Gjin Bibën.

BARDHI — More, po ç'dreqin ke me të?

DEDA — Gjin Biba është rrufjan i madh? I leverdis të marrë bijën tënde dhe ta forcojë edhe më tepër miqësinë me ne. Do të rregullojë biografinë e tij me tonën, po ne këtë nuk duhet ta pranojmë kurrë. Ti, Marta, ç'thua?

BARDHI — Ju e keni biseduar bashkë dhe tani më shitni mendje.

DEDA — Po, babë. Marta erdhi këtu e më tha se s'do të shkojë në atë shtëpi. Edhe në Komitet të Rinisë ka folur.

BARDHI — (*Bie në mendime.*) Prandaj ai po nxi-tohet. Eh, Gjin Biba, Gjin Biba!

DEDA — Punët janë të qarta.

BARDHI — Hë për hë këtë nuk jemi duke e këputur. Do ta pleqërojmë thellë dhe do të pyes edhe ata që duhet të pyes.

DEDA — Tani shkojmë nga menca e hamë drekë së bashku, se të them të drejtën, u lodhëm, babë!

Errësim. Fundi i tablosë së katërt

TABLO E PESTË .

I njëjti ambient i tablosë së parë, por tani furra vatërxhaketë ka marrë formën e saj. Kanë mbetur pa ngritur edhe dy xhaketa metalike.

LLAZI — (Tërë autoritet dhe me nerva të tendosura). Ku është parë të digjet motori kryesor për prodhimin e energjisë elektrike? Kjo është skandaloze dhe do të zgjidhet vetëm me gjyq. Dëgjuat? Vetëm me gjyq! Na turpëruat të gjithëve me këto pakujdesi e papjekuri të theksuara. Mblidhni mendjen se kështu s'behët... (Punëtorët dëgjojnë.)

PANDI — Unë nuk isha aty, shoku Llazi. Kjo avari ndodhi në ndërresën e Sotirit.

LLAZI — Unë nuk dua të di se kush nuk ishte. Të dy specialistë jeni e në mos marçi vesh ju, nga kush do presim?

PANDI — Përgjegjësinë ta mbajë Sotiri. Po, po, Sotiri! Ç'ne unë? Të gjitha në ndërresën e Sotirit ndodhin...

LLAZI — Këtë radhë fajtori le të përgjigjet deri në një. Mjaft jemi treguar dorëlëshuar.

- SOTIRI — Jam dakord, shoku Llazi. Unë edhe Pandi, le t'i nënshtrohemi drejtësisë popullore. Për veten time nuk kam frikë të jap llogari edhe atje.
- LLAZI — Mos u trego kaq trim, djalosh, se po u fute në ato dyer, nuk del kollaj.
- SOTIRI — Të paktën atje do të dalë drejtësia në shesh, se gjyqet tona kot nuk të dënojnë. Për këtë jam i bindur.
- LLAZI — *(E kupton vendosmërinë e tij dhe e tërheq mënjane.)* Prit, mos u nxito, djalosh!
- SOTIRI — *(Janë shkëputur nga punëtorët, të cilët vazhdojnë punën.)* Kështu nuk kalohet, shoku Llazi. Le të vinë shokët e prokurorisë dhe le të fillojnë nga hetimet. Sa më parë, aq më mirë.
- LLAZI — More, puna është ta mbyllim, pa ardhur ata e pa u bërë puna me gjyq.
- PANDI — Ju lutem, shoku Llazi, na ndihmoni! Edhe Sotiri nuk ka faj.
- SOTIRI — Mos e dridh dhe mos u bëj avukat për mua. Apo ke frikë nga gjyqi? Në qoftë se jam për gjyq, në gjyq të vete. Unë nuk i kërkoj kërkujt mëshirë; vetëm të dalë e drejta në shesh.
- PANDI — Mirë, shoku Llazi, dëngoje në gjyq, gjersa e kërkon vetë.
- SOTIRI — Të dy, po, po, të dy, do të japim llogari atje.
- PANDI — Ti po e kërkon vetë...
- SOTIRI — Po vajta unë, do të vish dhe ti.
- LLAZI — *(Për të shuar grindjen.)* Mos u zini, djema, mos bëni shamatë në mes të punëtorëve,

se po ju dëgjojnë të gjithë. Është turp, jeni akoma të rinj dhe s'e dini ç'domethënë gjyq. S'e keni provuar.

SOTIRI — Le ta provojmë, në qoftë se e kemi hak.

LLAZI — *(Autoritar.)* Mjaft, mos e zgjatni më këtë çështje se kam shpresë ta mbyllim këtu përbrenda. Kam biseduar dhe do të bisedoj përsëri me shokun Dedë dhe shokun Simon. Tani futjuni punës e tjetër herë kini kujdes të mos ndodhim avari të tilla.

SOTIRI — Çështjen e motorit të djegur të mos e lëmë pezull, shoku Llazi. Ta çojmë deri në fund. Të ndahet përgjegjësia.

LLAZI — Përgjegjësia bie mbi të dy, por unë nuk dua t'ju rëndo. Shumë gjëra po ndodhin në ndërresën tënde dhe në ato punime që drejton ti; prandaj mos e ngri shumë zërin. U kuptuam? *(E mbyll këtë çështje.)* Çfarë pune keni sot në dorë?

SOTIRI — Kam dërguar disa pjesë në oficinë për rigjenerim. Po shkoj të shoh, se ç'kanë bërë.

LLAZI — Mirë, shko, vetëm kujdes. Po ti, Pandi?

PANDI — Po vazhdojmë të ngremë xhaketat metalike. *(Sotiri kalon.)*

LLAZI — *(Pasi mbeten vetëm dhe duke e ulur zërin.)* Maskara, frikacak, s'di të manovrosh fare. *(Shikon anash, e tërheq mënjanë, e ul përsëri zërin.)* Planin e përfundove? Hë, se do të raportojmë, si e ke menduar shkatërrimin?

PANDI — Kam menduar dy variante. *(Hap një projekt.)* Le të jetë për çdo të papritur!

LLAZI — Tani folë, shkurt dhe qartë?

PANDI — Kur furra vatërxhaketë të ndizet, së bashku me ngarkesën e parë në mineral, do të fusim ca copra tullash, të cilat nuk shkrijnë në temperaturën që shkrin metali, Kështu ato do të zenë kanalet e daljes së metalit dhe ajo do të bllokohet brenda.

LLAZI — Kanali mund të bllokohet. Cili është varianti tjetër?

PANDI — Varianti tjetër... (Fshin duart.)

LLAZI — Vazhdo, si?

PANDI — Me anën e ujit.

LLAZI — Si, në ç'mënyrë?

PANDI — Për një kohë, furra vatërxhaketë do të furnizohet, me ujë nga rezervuari. Furra do të ketë ujë, gjersa të fillojë shkrija e mineralit. Temperatura do të jetë rritur 1000 deri 1100 gradë celsius. Pastaj uji do të ndërpritet e xhaketat do të skuqen. Atëherë pompat e ujit do të vihen sërish në punë dhe uji që do të bjerë në xhaketat e skuqura, do të shpërthejë tamam si eksplozion.

LLAZI — Shkatërrim nga themelet.

PANDI — Po.

LLAZI — Ne si do ta justifikojmë largimin para shpërthimit?

PANDI — Edhe për këtë kam menduar?

LLAZI — Folë!

PANDI — Menjëherë, sapo të ndërpritet uji dhe të skuqen xhaketat metalike, unë do të jap alarmin e do të sulem për të zhdukur avarinë! Në këtë kohë do të rrëzohem dhe do të bëj sikur jam aksidentuar në gjunjë dhe në shtyllën, kurrizore. Ju do të më shoqë-

roni për në spital, mundësisht jashtë rrethit.
Pastaj le të ndodhë çfarë të dojë...

LLAZI — *(U bie kraheve.)* Mirë e ke menduar punën për të zbatuar variantin e dytë. Cilin duhet të aktivizojmë në këtë lojë?

PANDI — Përveç Gjini Bibës, njeri tjetër nuk kemi. Atë e kam futur në kursin e kualifikimit për pompist, sipas porosisë tuaj.

LLAZI — Plani është i mirë, por... zbatimin s'di si do të vejë.

PANDI — Me çdo kusht. Gjini Bibën duhet ta kemi te pompat e lumit.

LLAZI — Do të merrem unë me shpërndarjen e punëtorëve atë ditë. Kujdes, ruaju nga të gjithë, hidh gurin e fshih dorën, që përgjegjësia të bjerë mbi të tjerët. Lidhur me Sotirin, i kam folur edhe Dedë Bardhit, për të krijuar terrenin e nevojshëm. *(Sheh disa punëtorë që vijjnë në drejtim të tyre. Ndërron bisedë dhe bën sikur i kërkon llogari Pandit.)* Mos u huto, po puno me mend në kokë. Studjoni më mirë projektet, bëini sytë katër. Nisu tani për në punë. Mos e zgjat më.

PANDI — Si urdhëron, shoku Llazi! *(Punëtorët kalojnë.)* Me Gjini Bibën punoni vetë.

LLAZI — Qelbanik burrë më duket! Të kryejmë këtë aksion, pastaj do ta zhdukim si një cofinë të keqe, se mund t'i vijë era më vonë. *(Ndahen në drejtime të kundërta. Ndriçohet zyra ku po punojnë Deda e Simoni. Vjen Sotiri për të biseduar me ta.)*

SOTIRI — Ka mundësi të më prisni?

DEDA — Urdhëroni!

- SIMONI — Ne po bëheshim gati të vinim atje, për të ngritur xhaketat metalike.
- SOTIRI — Më dëgjoni pesë minuta, pastaj shkojmë bashkë.
- DEDA — Çfarë ka ndodhur?
- SOTIRI — (I zënë ngushtë.) Si të them? Edhe unë nuk di si të flas e çfarë të them para jush.
- SIMONI — Çfarë të shqetëson?
- SOTIRI — Djegia e motorit. Si është e mundur të digjet. Sapo u vu në provë?
- DEDA — Këtë pyetje duhet të ta bëjmë ne.
- SOTIRI — Keni të drejtë, shoku Dedë.
- SIMONI — Jo, kështu, pa përgjegjësi nuk punohet. Për djegien e motorit të dy keni faj të rëndë, po ti më shumë.
- SOTIRI — Sepse ndodhi gjatë ndërresës sime?
- SIMONI — Raporti që na paraqiti Llazi ty të ngarkon me përgjegjësi të rëndë.
- SOTIRI — Nuk kam ardhur këtu që të shfajësohem. Në qoftë se jam fajtor, le të dënohem rëndë.
- SIMONI — Pse thua, në qoftë se jam?
- SOTIRI — Se nuk e ndjej veten fajtor.
- DEDA — Ti je djalë i ri dhe duhet të punosh më shumë nga të gjithë këtu. Apo ke mendimin se ata që kanë mbaruar studimet jashtë shtetit janë më të përgatitur dhe dinë më shumë se ti?
- SOTIRI — Jo, nuk e kam atë mendim. Por unë vras mendjen dhe shqetësohem, pse ndodhin kaq avari në turnin tim?
- SIMONI — Se ti tregohesh më i pakujdesshëm.
- DEDA — Të dy e keni marrë pak rrëmbyer.

SIMONI — Kemi përgjegjësi.

SOTIRI — Nuk më takon mua.

SIMONI — Me çfarë na siguron?

SOTIRI — Me jetën time.

SIMONI — Duhet fakte për të bindur të tjerët, jo fjalë.

SOTIRI — Unë kam besim te Partia se do ta gjejë të vërtetën, prandaj kam ardhur te ju; të bisedoj në rrugë Partie me sekretarin dhe drejtorin, si komunistë që jeni.

DEDA — Të tjerët kanë ardhur më parë për këtë çështje.

SOTIRI — Qënkam treguar më të shkathët.

DEDA — Po.

SOTIRI — Jam menduar gjatë, para se të vija këtu.

DEDA — Urdhëro, po të dëgjojmë.

SOTIRI — Në radhë të parë, ju betohem, se avaritë që kanë ndodhur në punë për ndërtimin e fabrikës e sidomos në furrën vatërxhaketë...

DEDA — Nuk kanë të bëjnë me ty. Po atëherë si shpjegohet që pjesa më e madhe e avarive, të cilat janë të pajustificueshme, kanë ndodhur në ato vende, ku ke punuar e drejtuar ti?

SOTIRI — (I zënë ngushtë.) Si të të them?...

SIMONI — Rastësi, apo tersllëk?

SOTIRI — Po' më goditni rëndë, shoku drejtor, por në turn s'punoj vetëm unë.

SIMONI — Ju jeni drejtues.

SOTIRI — Po turnin e marr nga të tjerët. Dhe kjo s'duhet harruar.

DEDA — Domethënë mund ta ketë fajin ai që ka punuar para teje?

SOTIRI — Nuk përjashtohet kjo mundësi.

DEDA — Atëherë vazhdo!

SOTIRI — Pandi nuk më duket i singertë.

DEDA — Përse?

SOTIRI — I trembet gjyqit.

DEDA — Po ti nuk i trembesh gjyqit?

SOTIRI — Jo, shoku Dedë.

DEDA — Ç'do të thuash me këtë?

SOTIRI — Kur shoku Llazi tha se do të na çonte në gjyq, ai u frikësua shumë.

DEDA — Pastaj?

SOTIRI — Nuk më duket i singertë.

SIMONI — Punimet në sektorët ku punon Pandi shkojnë mirë. Atje nuk kemi avari.

SOTIRI — Si të them... shpesh herë del me dy fytyra. Nga njëra anë përpiqet për punën, nga ana tjetër shprehet: «*Ne po e ndërtojmë fabrikën e shkrirjes, por materialin nuk do ta shkrijmë dot*». A nuk është kjo parullë disfatiste. Ose disa herë shprehet: «*Nuk e ngremë dot industrinë e rëndë, s'kemi forca*». Këto janë koncepte që duhen dënuar. Bile ato i ka dëgjuar edhe shoku Llazi. Shpeshherë zihen, shamatohen në sy të punëtorëve, por së fundi në një çanak hanë së bashku.

DEDA — Ku kërkon të dalësh me këto?

SOTIRI — Të shikohet puna e tyre. Shoku Llazi, një natë, në një bisedë më ka thënë: «*Kam miq atje matanë e do të na ndihmojnë*», «*politika s'dihet se si shkon*», e të tjerë.

DEDA — Kështu? (*Deda me Simonin shikojnë njëri-tjetrin.*) — Keni fakte për ta vënë Pandin me shpatulla për muri për djegien e motorit?

SOTIRI — (*Mendohet*). Fakte?

SIMONI — Gjykata kërkon fakte.

SOTIRI — Kam dëshmitar, se lidhjet elektrike i kemi bërë shumë të rregullta. Gjithë brigada ishte aty. E pastruam, e montuam, dy orë e vumë në prova, punoi për bukuri. Të nesërmen, posa e stakuam, e vumë në moto, bëri një shkrepje të fortë, sa desh na hodi në erë. Kështu ngjet vetëm atëherë, kur bëhen qëllimisht lidhje të shkurtëra.

DEDA — Keni parë njeri që të ketë hyrë në central natën, pasi keni ikur ju?

SOTIRI — Jo.

DEDA — Dëgjo, Sotir. Tani për tani çështjen e motorit do ta lëmë në heshtje.

SOTIRI — Pse, shoku Dedë?

DEDA — Jo, për të të shpëtuar ty, por për të nxjerrë të vërtetën në dritë. Ti përpiqu ta zbulosh, në se natën ka hyrë njeri në central dhe të na njoftosh menjëherë.

SOTIRI — Si urdhëron.

DEDA — Sotir, ti je i ri, e ke të ardhmen përpara, prandaj të kërkohet që të punosh e të vijësh me shumë, për të ngritur e mbrojtur fabrikën. Ju e dini se armiqtë na kanë bërë bllokadë. Ata bëjnë të gjitha përpjekjet që ne të dështojmë, prandaj ushtrojnë presione e shantazhe. Ndoshta kanë aktivizuar edhe njerëzit e tyre, që mund të jenë këtu e kërkojnë të bëjnë sabotime; ndaj kërkohet

të vigjëlojmë më shumë. Disa dëmtime ndosh-
ta s'kanë ngjarë rastësisht e na shtyjnë të
dyshojmë.

SOTIRI — Keni të drejtë, shoku Dedë.

DEDA — Ti duhet të informosh Partinë për çdo
gjë që të bije në sy, sidomos për çështje
teknike.

SOTIRI — Jo për të gjithë sektorët. Ka plot gjëra
që unë s'i di.

DEDA — Partia të dha shkollën, të bëri inxhinier,
prandaj duhet t'ia shpërblesh.

SOTIRI — (*Aprovon me kokë.*) E drejtë.

DEDA — Punëtorët të kanë kritikuar se kërkojnë
më shumë nga ti. Të kritikojnë se të duan,
bile të duan shumë. Disa herë kanë ardhur
gjer tek unë e shoku Simon, për të të mbrojtur.

SIMONI — Ti duhet të jesh më trim dhe të nde-
shesh pa frikë me vështirësitë, të kërkos
llogari e të kritikosh cilindo që nuk punon
mirë. Të flasësh hapur para punëtorëve dhe
specialistëve. Përse druhash?

SOTIRI — Kemi shokun Llazi.

DEDA — Do të kishe bërë mirë të kishe ardhur
më përpara. Po edhe tani s'është vonë. Këto
çështje do t'i shohim me gjakftohtësi, do t'i
studjojmë e do të nxjerrim konkluzionet e
nevojshme. Një këshillë do të të japim: të
jesh më i vëmendshëm për gjithçka.

SOTIRI — Mirëupafshim (*Del.*)

DEDA — Këto duhen parë mirë.

SIMONI — Dukej i shqetësuar.

DEDA — Të njoftojmë Komitetin e Partisë edhe për
këto.

SIMONI — Dakord. (*Ndriçohet furra vatërxhaketë e një grup punëtorësh e mekanikësh. Aty janë edhe Llazi e Pandi. Pas pak vjen Sotiri.*)

LLAZI — Ku ishe kështu, Sotir?

SOTIRI — Kisha pak punë.

LLAZI — E ku ka punë më të madhe sesa kjo që po bëjmë sot? Ndërsa ti... nuk e ke mendjen te puna.

SOTIRI — Për çështjen e furrës vatërxhaketë u vonova.

KOLA — (*Për të mbyllur bisedën.*) Shoku Llazi, saldimi me oksigjen ka dalë i mirë.

LLAZI — Të lumshin duart, o Kolë. E ke qarë fare!

PJETRI — Unë kam një frikë.

LLAZI — Çfarë?

PJETRI — (*Tregon me gisht.*) Ajo xhaketa e vjetër që riparuam nuk do të na shkojë gjatë. Ish-te tepër e oksiduar.

PANDI — Mos ki merak, e kam kontrolluar unë. (*Vinë Deda me Simonin, duke biseduar e shikuar punimet.*)

SIMONI — Ju lumtë, paskeni ecur shpejt!

LLAZI — S'ndalet vrulli i tyre, shoku drejtor.

SIMONI — Cilësia, si duket?

LLAZI — E mirë. Kësaj i kemi kushtuar më tepër kujdes, prandaj gjithnjë kam ngulur këmbë që të mos nxitohemi.

DEDA — Sotiri ka nevojë të qëndrojë më tepër afër furrës vatërxhaketë dhe të mësojë.

KOLA — Afër ka qëndruar, shoku Dedë.

LLAZI — Sotiri ka perspektivë, që të bëhet një metalurg i zoti.

NJË PUNËTOR — Shoku drejtor, nuk ma hante mendja se do të bëheshin kaq shpejt e kaq të mira këmishat metalike.

NJË PUNËTOR TJETËR — Edhe kaq të forta. Asnjë ndryshim me ato që na vinin nga importi.

DEDA — Si i thonë asaj fjalës, mali duket i lartë, sa pa u ngjitur, se pastaj hap pas hapi zvogëlohet.

LLAZI — Kola dhe Pjetri kanë dhënë një kontribut të madh për xhaketat.

KOLA — Të gjithë kanë punuar e ndihmuar, shoku Llazi.

LLAZI — Meqenëse edhe një xhaketë na ka mbetur. A e montojmë edhe këtë sot.

PJETRI — S'kemi si të presim më.

LLAZI — Atëherë përgatituni. Sotir, kontrolloje edhe një herë. (*Sotiri shikon me kujdes vendet e saldimit.*)

SOTIRI — Në rregull, shoku Llazi.

KOLA — Sotiri do të bëhet edhe një teknolog i zoti për metalurgjinë.

LLAZI — Është i ri.

DEDA — Sotiri ka edhe tradita. E dini, apo jo?

PANDI — Ku i gjeti traditat Sotiri?

DEDA — E ka pasur të atin bakërxhi. Shkonte fshat më fshat me torbën e veglave në krahë e ku kallaiste ndonjë enë, ku zinte ndonjë gjym të shpuar.

LLAZI — Këtë s'e kisha ditur. Ky qënka zbulim.

SOTIRI — (*I emocionuar*). Kur isha fëmijë ëndërrroja zanatin. Dyqani i tij i vogël që gjithë t'ym.

SIMONI — Kurse sot ne po ngremë goxha fabrikë.

- SOTIRI — As këtu nuk është lehtë, se bakri sjell-
ka nxehtësi të madhe.
- DEDA — Edhe ne nëpërmes kësaj nxehtësie po pi-
qemi. (Aty pari kalon Gjini Biba me një shinë
të shtrëmbër në krah.)
- GJINI — Kuvend i mbarë, burra!
- PJETRI — Nga po shkon me atë shinë të shtrembër,
Gjini Biba?
- GJINI — Te shinashtruesit.
- PJETËRI — Po nuk gjete ndonjë tjetër më të
drejtë?
- GJINI — Nuk kishte.
- SIMONI — Ktheu prapa, lëvizi të gjitha shinat dhe
gjej një më të mirë.
- GJINI — Besa u mundova boll, por...
- LLAZI — Zbato urdhërin, Gjini Biba, se të mori
dreqi. Puno mirë!
- GJINI — Po unë... shoku Llazi, duke punuar jam.
- LLAZI — Mbylle, bëj atë që të thanë.
- KOLA — Gjini, kujdes dhe mos u lodh shumë.
- PJETRI — E ka merak vetë.
- LLAZI — Lereni Gjinin, se është mizë para fa-
brikës.
- KOLA — Eh, o shoku Llazi, mizat janë shumë të
këqija, të dëmshme, përhapin sëmundje, se
shkojnë në turli vendesh. (Të gjithë qe-
shin.)
- GJINI — Mos më merrni nëpër këmbë, burra!
(Ikën.)
- DEDA — Edhe dy javë na mbetën, shokë. Këto
ditë t'i shpallim ditë sulmi. Ditën e ndezjes
së fabrikës do ta kthejmë në ditë feste.
- SIMONI — Edhe në repartet e tjera ka boll punë
por ju të furrës vatërxhaketë keni peshën

- kryesore. Këtu është zemra e fabrikës, prandaj e dini vetë.
- LLAZI — Rrini pa merak, shoku drejtor.
- SIMONI — Për sot mjaft, se vajti vonë. Nesër nisim sulmin e ri.
- TË GJITHË — Dakord. (*Shpërndahen. Kola me Pjetrin kapin Dedën.*)
- KOLA — Shoku Dedë!
- DEDA — Urdhëro, Kolë, dukeni pak të lodhur.
- KOLA — Nuk u lodhëm, por na dëgjo. (*E ulin zërin.*) Nuk e kuptojmë se ç'ka ai Pandi me Gjin Bibën? Shpesh herë bisedojnë jo hijshëm, fshehurazi.
- DEDA — Çfarë bisedojnë?
- PJETRI — Nuk e dimë. Kjo na ka rënë në sy pak si tepër.
- DEDA — Ju faleminderit!
- KOLA — Gjin Biba nuk është burrë i mirë. Këtë e dinë të gjithë. Ç'do Pandi me të, xhanëm? Ç'i lidh?
- DEDA — Ju sytë në ballë i keni. Nuk duhet vetëm të ndërtojmë, por edhe të vigjëlojmë.

Errësim. Fundi i tablosë së pestë

TABLO E GJASHTË

Furra vatërzhaketë ka përfunduar dhe është vënë në provë. Metalurgët po i bëjnë shërbimet e duhura. Ata lëvizin andej-këndej, shikojnë e kontrollojnë në vende të ndryshme. Çdo gjë shkon për bukuri. Dita e parë e shkrirjes është kthyer në ditë feste, vendi është zbukuruar, janë shkruar parulla, nëpërmjet qendrës së zërit jepet një muzikë e gëzuar. Në sfondin kryesor duket parulla:

«TË MBËSHTETEMI FUQISHËM NË FORCAT TONA, T'I JAPIM ATDHEUT SA MË SHUMË BAKËR.» Në fytyrat e punëtorëve shihet krenari e gëzim.

- DEDA — (Që vjen së bashku me Sotirin nga pas.)
Dëgjo, Sotir!
SOTIRI — Urdhëro, shoku Dedë.
DEDA — Si të duket fillimi?
SOTIRI — Çdo gjë po shkon sipas rregullave teknologjike.
DEDA — Sikur të na shkojë mirë çdo gjë deri në fund. Nuk ma ha mendja të mos bëjnë ndonjë përpjekje. Po ku?
SOTIRI — S'kanë ç'të bëjnë, shoku Dedë.

DEDA — Janë marrë të gjitha masat për dublimin e vendeve të punës?

SOTIRI — Po. Në centralin elektrik, te burimi i energjisë elektrike kemi vënë Lekën, te kompresorët e ajrit kemi Dilën, Gjak në vetull të merr.

DEDA — Ashtu.

SOTIRI — Në ngarkesën e furrës e kudo kemi zgjedhur njerëzit më të mirë.

DEDA — Është kapur një njeri që vinte në fabrikën tonë. Thonë se shërbente si ndërlidhës.

SOTIRI — Kur kështu?

DEDA — S'ka një javë. (*Vinë Simoni dhe Llazi.*)
Kujdes!

LLAZI — Çdo proces po shkon normalisht, shoku drejtor.

SIMONI — Ashtu duket.

DEDA — Tani gjithë merakun e kemi te furra. Kur të nxjerrim shkrirjen e parë, sipas zakonit edhe pushkë do shtijmë. Si thua, shoku drejtor?

SIMONI — Jo, për pushkë mos kërko leje kot; s'kemi nge të bëhet alarm.

(*Pandi nxjerr kokën lart. Është duke kontrolluar.*)

LLAZI — Hë, Pandi, si duket?

PANDI — (*Nga lart.*) Mbarë, shoku Llazi! Çdo gjë sipas planit.

SIMONI — Mirë, kini kujdes se mos aksidentohet njeri nga pakujdesia.

LLAZI — Porositë dhe këshillat për sigurimin teknik ua kemi dhënë me kohë.

DEDA — Megjithatë kujdesi nuk është kurrë i tepërt.

LLAZI — Që të gjithë e kemi merak, shoku Dedë.
(*Është afruar edhe Pandi.*)

PANDI — Ore, kush do të na qerasë sonte?

LLAZI — Drejtorisë i takon të zgjidhë qesen.

SIMONI — Drejtoria sonte ka shtruar një darkë në klubin e madh.

PANDI — Pa shaka!

SIMONI — Pa shaka. Secili me paratë e xhepit.

DEDA — Mos u bëni merak. Festat nuk janë larg.

(*Aty pari kalon Leka me disa vegla pune në dorë.*)

LLAZI — Leka!

LEKA — (*Me shkathtësi*) Urdhëroni, shoku Llazi.

LLAZI — (*I tërheq vëmendjen.*) Kujdes burimin elektrik dhe rrjetin se janë zemra dhe arteriet e fabrikës.

LEKA — E kemi merak vetë, inxhinier, kushedi sa prova kemi bërë.

LLAZI — Hë, më të lumtë! Këtë radhë e ke tundur fare! Për nder, shoku drejtor, ka punuar në mënyrë të shkëlqyer. Po e dha fjalën Leka, di edhe ta mbajë.

LEKA — Që të gjithë e mbajtën fjalën.

LLAZI — Rrjeti elektrik është shtrirë në kohë rekord dhe puna s'ka të sharë. T'ju them të drejtën, shokë, ia kisha frikën.

LEKA — Ju faleminderit! (*Ikën me shpejtësi*).

LLAZI — Djalë i shkathët, me iniciativë, ja, të kesh dhjetë a pesëmbëdhjetë si ky dhe e ve festen mbi sy.

DEDA — Mos të të vijë keq, o shoku Llazi, po nja dy herë ma ke sharë. Thoshe është i nxituar, nevrastenik dhe kokëfortë.

LLAZI — E hu, sa fjalë dhe zënka kemi pasur gjatë vitit, aq të mira paçim. Po pse i kemi bërë? Për interesin e punës, për ndërtimin e veprës.

SIMONI — Sa vajti ora? Presim të na vinë disa shokë nga Komiteti i Partisë, nga pushteti e Ministria, që të marrin pjesë në festën tonë dhe të përgëzojnë kolektivin për shkrimin e parë. (*Llazi*) Si ta merr mendja?

LLAZI — S'kemi asnjë merak. Shkojmë në sektorin tjetër. Ti, Pandi, kujdes!

(*Simoni, Deda, Llazi dhe Sotiri, dalin. Në anën e kundërt vjen Gjin Biba.*)

PANDI — Urdhëro çelësin e saraqineskave të pompave të ujit. Menjëherë do t'i mbyllësh e si të kalojnë 20 minuta, do t'i hapësh përsëri gjer në fund.

GJINI — Po më duket punë me zarar.

PANDI — Bëj kështu si të them unë dhe mbylle sqepin!

GJINI — Do të më kapin.

PANDI — S'ka kush të kap, mos u frikëso. Po të pyetën thuaju se pompat kanë punuar për mrekulli; asnjë ndërprerje nuk ka pasur. Zhduku tashti dhe mbaje mend atë që të tha-

shë. (Gjini ikën, Pandi thërret.) Bëni furnizimin e dytë! Edhe katër vagona me qymyr koks, dy me mineral, ajrin me kujdes, sa të rritet nxehtësia!

DISA PUNËTORË — (Që janë sipër, por nuk duken.) Si urdhëron! Edhe dy vagona! (Kola, Sotiri dhe Pjetri dalin në plan të parë, ndër-sa Pandi kalon duke kontrolluar me kujdes.)

KOLA — Sotir, mos u afro shumë, se mund të dalë me shpejtësi llava e metalinës e të djeg.

SOTIRI — Vetëm të rrjedhë. Dua ta shoh atë llavë të kuqe minerali, se kemi kaqë kohë që punojmë.

PJETRI — Për këtë ditë punuam, që kur hodhëm themelet.

KOLA — Këndej nga anët tona, Sotir, për truaillin dhe themelet kishin merak të madh. Themele të fortë, mure të trashë dhe të zbardhur me gëlqere jashtë.

SOTIRI — Kjo më ka bërë përshtypje. Vërtet, pse kishin dëshirë t'i zbardhnin?

KOLA — Që të pëllciste hasmi prej inatit, se qëllonte që i zoti i kullës të jetonte i mbledhur brenda si në kala me muaj e me vjete.

PJETRI — Zakone të këqija kemi pasur, he burrë.

SOTIRI — Babai më ka folur edhe për traditat e mira, për besën, trimërinë, mikpritjen dhe krenarinë.

KOLA — Këto i gjen kudo, si në jug ashtu edhe në veri.

SOTIRI — Sikur këndeje nga ju shkëlqejnë më tepër.

PJETRI — Ashtu të duket! *(Kalojnë duke i bërë shërbime furrës vatërçhaketë. Rrotull vijnë duke biseduar Llazi me Pandin.)*

LLAZI — Hë, Pandi, si po shkon puna?

PANDI — *(Me kujdes)* Mirë, shoku Llazi.

LLAZI — Gjin Biba e mori përsipër detyrën?

PANDI — Po.

LLAZI — *(Për ta provokuar)* Po sikur të dështojmë?

PANDI — Jo. I kemi bërë llogaritë deri më një.

LLAZI — Ka edhe më ujë rezervuari?

PANDI — Punë minutash.

LLAZI — Si s'po kalon kjo ora sot. Tri herë gjer tashti më është dukur, sikur më kishte mbetur sahati...

PANDI — Koha bën të vetën.

LLAZI — Dhe ne duhet të bëjmë tonën. *(Kalojnë disa punëtorë aty afër.)* Pandi, kujdes kanalët. Unë po kaloj nga ngarkesa kryesore.

PANDI — Mirë, shkoni pa merak! *(Llazi kalon. Vjen Kola).* Të lumtë, o Kolë, punë të mirë ke bërë. Na nderove dhe na nxore nga situata me këto xhaketat metalike.

KOLA — Se mos i bëra vetëm.

PANDI — Ti ke merita, se ishe i pari që propozove *(Xhaketat metalike fillojnë të nxehen shumë dhe të skuqen nga që është ndërprerë uji. Pandi bën sikur nuk e kupton, alarmohet shumë dhe bërtet).* Avari, shokë... avari! *(Hidhet i pari për ta shbllokuar avarinë, hipën lart, përpigjet dhe lëviz sa andej e kë-*

dej sa çorienton edhe të tjerët. Vjen me të shpejtë Simoni, Deda dhe punëtorë të tjerë.)
SIMONI — Çfarë ka ngjarë!?

KOLA — Avari, shoku drejtor, avari! *(Kola dhe të tjerët janë shumë të shqetësuar për ngjarjen.)*

DEDA — Si kështu?!

PJETRI — Avari, bile shumë e rëndë.

SOTIRI — Është shtuar shumë nxehtësia e furrës, xhaketat janë skuqur. *(Pandi që është ngjitur lart rrëzohet, lëshon një klithmë të fortë dhe bën sikur është aksidentuar rëndë në këmbë dhe në kokë.)*

KOLA — Pandi, Pandi!!!

PANDI — *(I rrëzuar, ashtu në kllapi).* Ah, ndihmë! *(Vjen Llazi me të shpejtë, i alarmuar në kulm.)*

LLAZI — Çfarë ka ndodhur!!!

DEDA — Avari, avari, shoku Llazi.

SIMONI — Edhe Pandi është plagosur rëndë.

DEDA — *(Merr komandën)* Lajmëroni mjekun, merrni makinën e drejtorisë dhe dërgojeni në spital. *(Llazi në këtë kohë ka shkuar pranë Pandit, punëtorët janë hedhur në aksion për të shbllokuar avarinë.)*

LLAZI — Qënka aksidentuar rëndë. Unë po e shoqëroj Pandin për në spital. Ti, Sotir, mirru me eliminimin e avarisë. Së shpejti do të kthehem.

DEDA — Ju, shoku Llazi, duhet të qëndroni këtu.

LLAZI — Të qëndroj këtu?! Po këtij ç'ti bëjmë?

DEDA — Me Pandin të merren të tjerët, ka plot

shokë që mund t'i vinë në ndihmë. (*Shqetësim i përgjithshëm, xhaketat metalike skuqen edhe më tepër, nxehtësia vazhdon të shtohet, Llazi bën të niset.*) Mos shkoni, shoku Llazi!

LLAZI — Si të mos shkoj. Pandi është dëmtuar rëndë. Është në rrezik jete? Unë do të kthehem shpejt.

DEDA — (*Është duke u marrë edhe me punën. I kërcënohet me tërë forcën.*) Do të përgjigjesh për këtë. Kur ka avari, inxhinieri nuk e braktis punën.

LLAZI — (*Me disa punëtorë niset, duke mbajtur Pandin në krahë. Pandi bën sikur ka humbur ndjenjat.*) Do të kthehem, sa të dërgoj Pandin në spital! Kam merak për jetën e tij. Njeriu kapitali më i çmuar. (*Ikën. Të gjithë përpiqen të zhdukin avarinë.*)

DISA — Për nder, iku!

SOTIRI — (*Që është marrë me kontrollin paraprak.*) Shoku Dedë!

DEDA — (*Që i është përveshur punës*) Urdhëro!

SOTIRI — Ka mbaruar ujët në rezervuar, pompat e lumit janë stakuar.

DEDA — Kush i ka stakuar ato?!

SOTIRI — Nuk e di.

SIMONI — Kush është te pompat e lumit?

PJETRI — Gjin Biba me Llesh Jakun.

DEDA — Ashtu?! (*Dëgjohet gurgullima e ujit që vjen me vrull.*)

SOTIRI — (*Thërret me zë të lartë.*) Kush i stakoi pompat e lumit?! Shokë, mbyllni seraqineskat, që të mos bjerë uji në xhaketat metalike.

Me çdo kusht të ndalohet uji! (*Vetë Sotiri dhe Deda mbyllin saraqineskën e madhe, duke punuar me shpejtësi.*)

DEDA — Sabotim!

SOTIRI — Po, shoku Dedë.

SIMONI — Kjo duket si e organizuar.

SOTIRI — Sabotim, shoku drejtor.

DEDA — (*Ngrihet në këmbë dhe urdhëron.*) Shokë, bllokoni postbllokun. Asnjëri të mos hyjë e të mos dalë! Gjini Bibën ta sillni këtu, gjallë, ose të vdekur.

SOTIRI — (*Pasi ka mbyllur saraqineskën kryesore.*) Kolë, Pjetër, Lekë, hapni kanalën rezervë të furrës vatërshaketë për shkarkimin e metalinës.

KOLA — Ç'eshtë kështu, dështuam?!

DEDA — Jo... fituam, shokë!

SOTIRI — Fituam, vëllezër! (*Punëtorët sjellin Gjini Bibën, i cili po dridhet si purtekë.*)

SIMONI — Kush të dërgoi ty te pompat e lumit?

GJINI — Pandi, shoku drejtor.

DEDA — Përse i kishe stakuar pompat e lumit dhe i takove me vonesë, qen bir qeni?

GJINI — (*Heziton.*) Po unë...

PJETRI — Përgjigju, se ja, këtu ta bëmë varrin!

GJINI — Më kishin porositur.

DEDA — Cili?

GJINI — Pandi. (*Vjen Llazi, që bën sikur nuk di gjë. Gjini Bibën e fshehin pas tyre.*)

LLAZI — (*Gjoja i gëzuar.*) Hë, e zhdukët avarinë? Ju lumtë! E dija se do të kalonte shpejt, s'që kushedi se çë.

DEDA — (*I prerë.*) Po. (*E shikon me neveri.*)

- LLAZI — Ju thashë se do të kalojë shpejt dhe pa dëmtime. Kështu e ka shkrija. (*Do të ngjitet atje tek janë Deda, Simoni, Sotiri dhe Kola.*)
- DEDA — Rri aty ku je dhe përgjigju për ato që do të të pyesin!
- LLAZI — Çfarë ka ndodhur?!
- DEDA — (*Me ironi therëse*). Kush dha urdhër të stakohen pompat e ujit?
- LLAZI — Nuk di gjë.
- DEDA — (*Përsëri me ironi.*) Tani e keni kot që mundoheni të fshiheni!
- LLAZI — Si guxoni të shprehni kështu?
- SIMONI — Doje të shpëtoje një që të shkonin qindra të tjerë?!
- DEDA — Prapa avarisë fshihej sabotimi.
- LLAZI — Protestoj... Protestoj!...
- SIMONI — Mjaft!
- LLAZI — Me çfakte më akuzoni?
- DEDA — Nxirreni qelbanikun! (*Punëtorët e shtyjnë dhe i lëshojnë përpara Gjin Bibën*). Doni të tjera fakte, doni të tjera prova?
- LLAZI — (*Mundohet të largojë Gjin Bibën.*) Ky është maskara! Ky e ka bërë këtë!
- SIMONI — Që të tre jeni maskarenj. Që të tre do të jepni llogari!
- LLAZI — Kjo është e padrejtë!
- DEDA — Të drejtën do ta gjejë gjyqi.
- LLAZI — Po përse?
- DEDA — Për sabotim dhe për ato të tjerat që ti i di mirë. Lakrorit iu zbuluan petët. Kutia e duhanit s'hyn më në punë.
- SIMONI — Ratë vetë në gropën që përgatitet për të tjerët.

DEDA — (Që ka zotëruar të gjithë ambientin, ku janë mbledhur punëtorët.) Nuk ma merrte mendja se do të arrinit gjer këtu, sa të shkatërronit punën dhe djersën e mijëra duarve. Po a ka ligësi më të madhe se kjo, a ka veprim më kriminal? Shokë, bëni ngarkesën me mineral, mbusheni furrën vatër-xhaketë me mineral të kësaj toke, lëshoni qymyr, i jepni më tepër ajër fabrikës, që të fillojë frymëmarrjen dhe llava e kuqe e bakrit të rrjedhë e pastër. (Ndihet zhurma e punës.)

F u n d i i d r a m ë s